



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

PROJEKTI TRANSPARENCA NË SISTEMIN SHËNDETËSOR

**STUDIM KRAHASUES MBI SISTEMET E DEKLARIMIT TË
PASURIVE DHE KUADROVE LIGJORE PËR MAKSIMIZIMIN E
TRANSPARENCËS**

USAID/Transparenca në Sistemin Shëndetësor

Informacion mbi Projektin:

Ky program është mundësuar nga mbështetja bujare e Popullit Amerikan nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nëpërmjet termave të kontratës me nr AID-182-C-17-00001. Ky projekt zbatohet nga University Research Company, LLC (URC) dhe nën kontraktuesit e tij Instituti Shqiptar i Shkencës (AIS), Tetra Tech, dhe Universiteti i Bostonit.

Përmbajtja e këtij manuali është përgjegjësi vetëm e projektit dhe nuk reflekton detyrimisht pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë Amerikane.

U përgatit nga:

Slagjana Taseva, Ph.D, Konsulente, Instituti Shqiptar i Shkencës

Për më shumë informacion kontaktoni

Darcie Nielsen
Drejtoreshë e Projektit
University Research Co., LLC
Tel: + 355 (0) 42228945
Cel: + 355 (0) 676046719
Web: www.urc-chs.com

Neeraj Kak, Ph.D.
Zv. President
University Research Co., LLC
Tel: +1-301-941-8626
Cel: +1-240-460-6250
Web: www.urc-chs.com

Përmbajtja

Përhapja e sistemeve të deklarimit të nëpunësve publikë.....	4
Standardet Ndërkombëtare.....	5
Qëllimet e Sistemeve të Deklarimit.....	6
Baza Ligjore.....	8
Legjislacioni i posaçëm.....	8
Rregullimi institucional.....	9
Luhatjet dhe vazhdueshmëria e sistemeve të reja.....	11
Përpunimi i Deklarimeve.....	11
Kur dorëzohen formularët e deklarimeve.....	12
Mbledhja.....	13
Verifikimi.....	13
Përmbledhje e llojeve të ndryshme të kontrollit të deklarimeve në Shqipëri.....	13
Sistemi i deklarimit të interesave private në Shqipëri.....	14
Serbia.....	16
Letonia.....	16
Polonia.....	17
Rumania.....	18
Qasja në baza të dhënash dhe verifikimi.....	20
Sanksionet.....	21
Gjeorgjia.....	21
Sllovenia.....	23
Maqedonia.....	23
Përdorimi i Teknologjisë për menaxhimin e pajtueshmërisë së të dhënave.....	24
Procesi i Dorëzimit.....	24
Sistemet për menaxhimin e të dhënave.....	25
Përdorimi i Teknologjisë për verifikimin e deklaratave të pasurisë.....	25
Përzgjedhja për verifikim e deklaratave.....	26
Mënyrat e Verifikimit.....	26
Zgjidhje Elektronike për thjeshtimin e aksesit publik në deklaratimet e pasurive.....	27
Zgjidhjet Teknike.....	27
Shembuj nga vende të ndryshme.....	28
Argjentina.....	27
Sistemi i Deklarimeve në Meksikë.....	29
Gjeorgjia.....	30
Indonezia.....	30
Sfidat.....	31
Kostot.....	32
Referenca.....	33
Aneks I.....	34
Aneks II.....	36

Përhapja e sistemeve të deklarimit të nëpunësve publikë

Përveç disa rasteve të mëparshme, sistemet e deklarimeve të nëpunësve publikë filluan të përhapen në versionet e tyre moderne pas Luftës së Dytë Botërore (Burdescu *et al.*, 2009, Figura 1, f. 29). Në Shtetet e Bashkuara, skandalet gjithmonë e më të mëdha të korrupsionit në qeverisje dhe të përsëritura krijuan një shtysë për ndërmarrjen e nismave për forcimin e integritetit të sferës publike. Një nga deklaratat e më hershme politike në lidhje me nevojën për imponimin e deklarimit publik të financave personale për nëpunës të caktuar federalë u shpreh në mesazhin e Presidentit Truman para Kongresit në vitin 1951: "Me gjithë këto çështje që po ngrihen sot rreth ndershmërisë së nëpunësve publikë, mendoj se që të gjithë ne duhet të përgatitemi për të bërë të ditur fakte rreth të ardhurave tona publikisht". Faktorë të ndryshëm e parandaluan futjen e deklarimeve të nëpunësve publikë në nivel federal në vitet 1950. Vetëm në vitin 1965, ishte Presidenti Lyndon B. Johnson, ai që kërkoi që nëpunësit federal të deklarorin informacione rreth financave të tyre publike para autoriteteve publike (Mackenzie and Hafken, 2002, f. 24-26). U deshën Watergate-i dhe skandale të tjera deri sa Kongresi Amerikan të miratonte Ligjin për Etikën në Qeverisje në vitin 1978. Ky Akt, ende në fuqi edhe sot e kësaj dite, kërkon që nëpunësit e qeverisë mbi një nivel të caktuar të të tre degëve të qeverisë federale të bëjnë publike në mënyrë të hollësishme financat e tyre. Qysh në vitin 1950, nismat për publikimin e financave u materializuan edhe në nivelin e shtetit Amerikan. Deri në vitin 1969, ishin 11 shtete që e kishin të detyrueshëm deklarimin publik (Anechiarico and Jacobs, 1996, f. 47). Kërkesat për publikimin e informacioneve financiare filluan të përhapen gjerësisht në vitet 1970 (Anechiarico and Jacobs, 1996, f. 47-48). Numri gjithmonë në rritje i zyrtarëve që mbulonte ky ligj dhe gama e informacioneve të detyrueshme për tu deklaruar çoi në gjyqe të shumta, ku zyrtarët pretendonin se ky deklarim cenonte të drejtën e privatësisë. Shtetet e Bashkuara panë një valë çështjesh të tilla gjyqësore në vitet 1970. Megjithatë, rezultati i këtyre çështjeve gjyqësore ishte njohja gjerësisht e autoritetit të shtetit për ta bërë deklarimin të detyrueshëm (Rohr, 1998, f. 44-45). Deklarimi të ardhurave, pasurive dhe interesave financiare të nëpunësve publikë filloi më pas edhe në pjesën më të madhe të Evropës Perëndimore. Përrjashtim përbënte Mbretëria e Bashkuar – një vend që miratoi Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit qysh në vitin 1889. Provat historike tregojnë se parlamenti përgjithësisht hezitonte të vendoste rregulla strikte mbi deklarimin. Një komitet i përzgjedhur i ngritur në vitin 1969 doli prapë se prapë në përfundimin se nuk ishte e nevojshme të hapej një regjistër interesash, për shkak të besimit tek nderi dhe vetëpërmbytja e deputetëve. Megjithatë, në vitin 1974, Dhoma e Përfaqësuesve (House of Commons) miratoi krijimin e Regjistrit të Interesave. Edhe pas vitit 1974, çështja se çfarë përbënte saktësisht interes relevant për tu deklaruar ose për tu regjistruar mbetej deri diku një pyetje e hapur e cila konsiderohej nga disa si një çështje që i takonte vetë Deputetëve për ta vendosur (Doig, 1996, f. 42, 44). Deklarimi i nëpunësve publikë u përhap edhe më tej në Evropën Perëndimore në vitet 1980. Në vitin 1982, ligji për deklarimet u miratua edhe në Spanjë. Po atë vit, deputetët italian u detyruan të bënin publike të ardhurat e tyre shtesë dhe statusin e pronësisë së pasurive të ndryshme. Në vitin 1983, ishte Portugalia ajo që miratoi një ligj për kontrollin publik të pasurive të zyrtarëve të zgjedhur. Regjimet e mëparshme – dhe deri diku edhe regjimet e tanishme – të deklarimeve publike të vendeve të Evropës Perëndimore nuk përputhen me sistemin Amerikan sa i përket kompleksitetit, gamës në nëpunësve apo mekanizmave të zbatimit. Fundi i viteve 1980 dhe 1990 pa një lloj demokratizimi në pjesën më të madhe të Evropës Qendrore dhe Perëndimore dhe gjatë. Në regjimin socialist nëpunësit publikë nuk ishin përgjithësisht të

detyruar të deklaronin asnjë lloj të ardhure apo pasurie. Paralel me rritjen gjithmonë e më shumë të agjendës globale kundër korrupsionit, dolën vazhdimisht vende të reja që miratuan sistemet e deklarimit dhe zgjeruan objektin dhe shkallën e deklarimeve të sistemeve të vjetra. Shumë vende ish-socialiste miratuan legjislacione që kërkonin deklarimin nga nëpunësit publikë gjatë viteve 1990.

Të gjitha vendet e rajonit që u bënë pjesë e Bashkimit Evropian në vitin 2004 dhe 2007 kanë miratuar sistemet e tyre të deklarimit në vitet 2000. Kjo mund të shpjegohet me kushtet për anëtarësimin në BE, por kjo tendencë vazhdon edhe në shekullin e 21, kur si vendet aspirantë për anëtarësim në BE, ashtu edhe ish-Republikat Sovjetike që nuk kanë ambicie të tilla kanë miratuar rregulla të tilla për deklarimet.

Standardet Ndërkombëtare

Vitet 1990 panë jo vetëm një përhapje të deklarimeve në vendet e tranzicionit, por edhe daljen e standardeve ndërkombëtare kryesisht rekomanduese për këtë qëllim. Një nga dokumentet më të hershme ndërkombëtare që parashikoi deklarimet e nëpunësve publikë ishte Konventa Ndër-Amerikane Kundër Korrupsionit (miratuar në vitin 1996). Kjo konventë përcaktonte një kërkesë për shtetet palë që të shihnin mundësinë e marrjes së masave për krijimin, ruajtjen dhe forcimin *inter alia* të “sistemeve për regjistrimin e të ardhurave, pasurive dhe përgjegjësive të personave që ushtrojnë funksione publike në poste të caktuara siç parashikohet me ligj dhe, sipas rastit, për bërjen e tyre publike”. 2 Konventa e Unionit Afrikan për Parandalimin dhe Luftën ndaj Korrupsionit (miratuar në vitin 2003) i angazhon shtetet palë që tu “kërkojnë të gjithë nëpunësve ose nëpunësve të emëruar publikë të deklarojnë pasuritë e tyre në kohën e emërimit në detyrë, si dhe gjatë kohës në detyrë dhe pas mandatit të tyre në shërbimin publik.

Standardi më i hershëm evropian gjendet në Rekomandimin Nr. R (2000) 10 të Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për kodet e sjelljes për nëpunësit publikë (miratuar më 11 maj 2000), ku Neni 14 i referohet deklarimeve, d.m.th. “zyrtari publik, që mban një post, në të cilin interesat e tij ose të saj personale ose private mund të ndikohen nga detyrat e tij ose të saj zyrtare duhet, siç e kërkon ligji, të deklarojë në momentin e emërimit dhe në mënyrë periodike më pas dhe sa herë të ketë ndryshime natyrën dhe shkallën e këtyre interesave”. Duhet theksuar se rekomandimi i mëshon vetëm qëllimit të deklarimit për kontrollin e konfliktit të interesit – jo monitorimit të pasurisë, gjë që shihet si e rëndësishme në një sërë vendesh.

Kushtet e aplikuara në rastin e vendeve që dëshirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian nuk përbëjnë përgjithësisht një kriter të qartë për ngritjen e një sistemi deklarimi për nëpunësit publikë (nuk ka ndonjë ligj të BE-së – apo *acquis communautaire* – për deklarimet). Qëndrimi i BE-së, i shprehur në terma të përgjithshëm, përfshinte kriterin “që vendet candidate të arrinin një lloj stabiliteti të institucioneve që garantonte demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut...”. 4 Ndërkohë, vendet candidate pritësit ë përmbushnin kriteret e standardeve ndërkombëtare relevante dhe të fusnin në përdorim procedura të ndryshme kundër korrupsionit. Përveç kësaj, vende të caktuara kanë marrë edhe kërkesa konkrete për zbatimin apo forcimin e masave për kontrollin e konflikteve të interesit dhe verifikimin e pasurive të nëpunësve publikë si pjesë e kërkesës së BE-së për kontrollin e korrupsionit.

Kështu, ndonëse nuk ka një bazë ligjore të detyrueshme dhe nuk kërkohen prova konfirmuese për efikasitetin e tyre, deklarimet e nëpunësve publikë janë bërë *de facto* standard i Bashkimit Evropian *vis-à-vis* vendeve candidate. Siç u theksua më sipër, që të

dhjeta vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore që janë bërë pjesë e Bashkimit Evropian në shekullin e 21, kanë ngritur sisteme të tilla më pak ose më shumë efikente që përpara anëtarësimit në BE. Funksionimi i sistemeve të deklarimit vazhdon të jetë nën mbikëqyrjen e Komisionit Evropian në vendet aktualisht kandidatë.

Sot, deklaramet e nëpunësve publikë janë bërë pjesë e standardit global mishëruar në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (miratuar në vitin 2003). Neni 8 (Paragrafi 5) përmban një standard rekomandues, i cili kërkon nga shtetet palë të “përpiqen, aty ku është e mundur dhe në përputhje me parimet themelore të legjislacionit vendas, të marrin masa dhe të ngrenë sisteme që u kërkojnë nëpunësve publikë të deklarojnë para autoriteteve përkatëse lidhur me, *inter alia*, aktivitetet e tyre jashtë funksionit zyrtarë, punësimin, investimet, pasuritë dhe dhuratat apo përfitimet e konsiderueshme, prej nga mund të rrjedhë një konflikt interesi sa u përket funksioneve të tyre si nëpunës publikë.”

Konventa e trajton çështjen e deklarimit në kontekstin e rikuperimit të pasurive duke kërkuar që “çdo shtet palë të shohë mundësinë e ngritjes, në përputhje me legjislacionin vendas, të sistemeve efikase të deklarimeve financiare për nëpunësit e përshtatshëm publikë dhe që të parashikojnë sanksione të përshtatshme për mosrespektimin e këtij sistemi. Çdo shtet palë duhet gjithashtu të shohë mundësinë e marrjes së masave të tilla, sipas nevojës, për tu lejuar autoriteteve kompetente që ta shkëmbejnë këtë informacion me autoritetet kompetente në shtete të tjera palë, kur është e nevojshme të hetohet, të ngrihen akuza apo të rikuperohen të ardhurat nga vepra penale parashikuar në përputhje me këtë Konventë” (Neni 52, Paragrafi 5).

Kërkesat e Konventës së OKB-së nuk shkojnë përtej detyrimit për të konsideruar mundësitë që ajo parashtron. E megjithatë, duke huazuar gjuhën e Udhëzimeve Legjislative për zbatimin e Konventës së OKB-së Kundër Korrupsionit (OKB, 2006, Paragrafi 12, f. 4), është e qartë se shteteve u bëhet thirrje për të konsideruar ngritjen e sistemeve të tilla të deklarimit dhe për të bërë një përpjekje të sinqertë për të përcaktuar nëse këto sisteme do të ishin në përputhje me sistemin e tyre ligjor.

Qëllimet e Sistemeve të Deklarimit

Kontrolli i konfliktit të interesit – Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit i referohet qartë mundësisë së konfliktit të interesit si një standard bazë për qëllimin e deklarimit të informacioneve. Kjo pasqyron faktin që kontrolli i konfliktit të interesit është qëllimi kryesor i përdorimit të deklarimeve të nëpunësve publikë. Mund të thuhet se parandalimi i konfliktit të interesit fokusohet deri diku ngushtësisht në faktin nëse një interes i caktuar mund të ndërhyjë në ushtrimin e detyrave zyrtare. Ndërkohë, ka edhe shqetësime të tjera më të gjera sa i përket llogaridhënies publike, rritjes së mundësisë së përgjithshme të vlerësimit të aktiviteteve të një nëpunësi publik, duke përfshirë edhe motivet personale që ai apo ajo punonjëse mund të ketë.

Transparenca dhe llogaridhënia publike – Së bashku me parandalimin e konfliktit të interesit, shqetësimet më të përgjithshme rreth transparencës, llogaridhënies publike, besimit dhe integritetit përbëjnë qëllimet më gjerësisht të deklaruara të sistemeve të deklarimit. Këto qëllime nuk janë aspak kontradiktore; ato reflektojnë rëndësinë politike që ka njëri apo tjetri sistem. Historikisht, e drejta e kërkesës së qeverisjes, ka përfshirë më gjerësisht edhe të drejtën për tu njohur me informacione të zotëruara nga qeveria. Në rastet ku përmbajtja e deklarimeve të nëpunësve publikë vihet në dispozicion të publikut, ky instrument e shtrin thelbësisht mbulimin e së drejtës së informimit (ose lirisë së informimit, siç quhet shpesh kjo e drejtë), edhe në lidhje me të dhënat private të nëpunësve qeveritar.

Verifikimi i legjitimitetit të të ardhurave dhe pasurive është një tjetër qëllim, shpesh i shprehur ose të paktën i nënkuptuar. Standardet ndërkombëtare nuk i lidhin shprehimisht deklaratimet me nevojën e monitorimit të pasurive të nëpunësve publikë. Ndryshe nga parandalimi i konfliktit të interesit dhe llogaridhënia publike, shtetet kanë zakonisht për qëllim të ruajnë një lloj kontrolli mbi të ardhurat dhe pasuritë e të gjithëve dhe jo vetëm ndaj të ardhurave dhe pasurive të banorëve të tyre. Megjithatë, në disa vende, pranohet ideja se deklaratimet e nëpunësve publikë duhet të shërbejnë si një instrument i posaçëm për monitorimin e pasurive. Argumentimi i kësaj ideje është që nëpunësit publikë duhet t'i nënshtrohen një mbikëqyrjeje më të rreptë sesa pjesa tjetër e popullatës.

Hong Kong-u ishte i pari vend që përdori deklaratimet financiare për monitorimin e pasurive të zyrtarëve (Messick, 2009, f. 13). Ndonëse nuk është praktik shumë e zakonshme, vende të tjera i kanë mëshuar edhe monitorimit të pasurive. Për shembull në Shqipëri, qëllimi i shprehur i Ligjit për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe Disa Nëpunësve Publikë është “vendosja e rregullave për deklarin dhe kontrollin e pasurive, legjitimitetin e burimeve të krijimit të tyre, detyrimeve financiare të të zgjedhurve, nëpunësve publikë, familjeve të tyre dhe personave që lidhen me ta.”

Nga pikëpamja e zbatimit, monitorimi i rregullt i ligjshmërisë së pronave dhe të ardhurave duket më i vështirë nga ana teknike dhe ligjore sesa kontrolli i konfliktit të interesave. Nga ana tjetër, kontrolli efikas i konfliktit të interesit varet shumë nga të kuptuarit siç duhet të çështjes dhe nga kultura e punonjësve të sektorit publik, ndërsa zbatimi i tij mes masash të ashpra ligjore të vetme është pothuajse i pamundur.

Në Evropën Lindore dhe Qendrore, motivimi i fortë i shumë vendeve për tu bërë pjesë e Bashkimit Evropian i ka shtyrë ato të miratojnë ligje të ndryshme kundër korrupsionit. Miratimi me ligj i deklaratimit të pasurive mund të jetë një mënyrë e lehtë për demonstrimin nga ana e qeverive të vendosmërisë së tyre për të bërë diçka rreth problemit të korrupsionit. Detyra e vendeve kandidate u lehtësua edhe më shumë nga fakti që Komisioni Evropian nuk ka zotëruar asnjëherë asnjë provë materiale lidhur me efikasitetin e çfarëdolloj zgjidhje specifike në lidhje me deklaratimet e nëpunësve publikë. Si rrjedhojë, pothuajse çdo përpjekje e demonstruar – madje edhe nëse bëhet fjalë për përpjekje tejet formale – nga vendet për të forcuar sistemet e tyre është konsideruar zakonisht si progres.

Gjithashtu, edhe në pjesë të tjera të botës, organizatat ndërkombëtare dhe presioni i donatorëve (për shembull nga Këshilli i Evropës, USAID-i dhe Banka Botërore) ka ndihmuar në çuarjen drejt miratimit me ligj të deklaratimeve të nëpunësve publikë dhe masave të tjera kundër korrupsionit. Normalisht, respektimi i standardeve ndërkombëtare apo kritereve të donatorëve nuk gjendet ndër qëllimet e shprehura të sistemeve të deklaratimit, por ai mund të përbëjë një shtysë të konsiderueshme ose vendimtare për miratimin e tyre.

Kjo nuk do të thotë se sistemet e miratuara për këto arsye apo për arsye të tjera të ngjashme politike janë domosdoshmërisht të kota ose jo-efikase. Në fakt, masat kundër korrupsionit mund të jenë të rëndësishme edhe nëse pasojat e tyre janë kryesisht simbolike. Megjithatë, theksi i kuptimit simbolik të masave dhe mungesa e qëllimeve të vërteta politike në një lloj kuptimi teknik çojnë shpesh në shpërfillje të kostove dhe të pasojave anësore negative, si dhe në një lloj neglizhence sa i përket nevojës së ngritjes së një sistemi zbatimi vërtet efikas. Shumica e vendeve e kanë të vështirë të identifikojnë koston e operimit të sistemeve të deklaratimit, ndërkohë që disa të tjera hasin mos-respektim masiv nga ana e nëpunësve publikë të paktën vitet e para pas futjes së tyre në përdorim.

Sa më sipër, tregon rëndësinë e debateve të vërteta nga pikëpamja e politikave në rastet e miratimit apo modifikimit të sistemeve të deklaratimit. Ndonëse aktorët ndërkombëtar mund të

luajnë një rol të konsiderueshëm si katalizatorë ndryshimi, ata duhet të angazhohen në debate të duhura politikash me partnerët vendas, duke përfshirë politikanët, agjencitë qeveritare, OJQ-të dhe median.

Shënim

1. Neni 1 i Ligjit për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe disa Nëpunësve Publikë të Shqipërisë. Është e rëndësishme të theksohet se edhe kontrolli i konfliktit të interesit përben një qëllim të rëndësishëm të sistemit shqiptar në tërësi.

Baza Ligjore

Si bazë ligjore për deklarimet e nëpunësve publikë mund të shërbejnë disa lloje rregullimesh. Zakonisht, deklarimet e pasurive rregullohen me ligj të posaçëm ose me një pjesë në një ligj tjetër që parashikon qëllimin, objektin dhe mënyrën e organizimit të sistemit. Kjo varet nëse deklarimet përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të një legjislacioni gjithëpërfshirës kundër korrupsionit apo janë thjesht një ndër shumë procedura në kuadrin ligjor të shërbimit civil

Legjislacioni i përgjithshëm:

- *Ligjet për shërbimin civil dhe procedurën administrative* – Legjislacioni i shërbimit civil (shtetëror) dhe ligjet e procedurave administrative mbulojnë dy fusha të dallueshme të rregullimeve ligjore, por përbëjnë që të dyja pjesë të kuadrit ligjor të një shteti. Për këtë arsye, deklarimet e pasurive kërkohen nga një prej këtyre kuadrove ligjore thelbësore që rregullojnë administratën publike dhe jo si pjesë e ndonjë projekti të posaçëm kundër korrupsionit. Në varësi të vendit, ligjet për shërbimin civil mund të mbulojnë vetëm nëpunës publikë që mbajnë pozicione jo-politike në administratë (referuar zakonisht si nëpunës civil) ose, më gjerësisht, zyrtarë gjyqësorë dhe/ose të emëruar/të zgjedhur politikisht.
- Në këtë kategori nuk gjenden dy lloje kryesore legjislacioni. Një është detyra për dorëzimin sistematik të deklarimeve parashikuar nga ligjet e mësipërme, për shembull në Bjellorusi dhe në Ukrainë. Një tjetër lloj legjislacioni është detyra për njoftimin e eprorit rreth punësimeve të tjera jashtë punës dhe interesave private, por jo domosdoshmërisht në formën e një deklarimi sistematik. Disa shembuj përfshijnë parashikimet ligjore në Ligjin për Nëpunësit Federal (*Bundesbeamtengesetz*) në Gjermani dhe ligjet për procedurën administrative në Gjermani, Norvegji dhe Suedi.

Legjislacioni i posaçëm

Deklaratat si pjesë e ligjeve për anti-korrupsionin dhe kontrollin e konfliktit të interesit - Kjo qasje vë theksin shumë qartë te rëndësia e deklaratave për parandalimin e konfliktit të interesit dhe korrupsionit. Ligjet e tilla janë më të zakonshme në vendet që kanë kaluar tranzicion nga sundimi socialist.²

- *Ligjet e posaçme për deklaratat*– Këto janë akte legjislative të dedikuara që merren vetëm ose kryesisht me deklaratat e zyrtarëve publikë. Ashtu si kategoria e mëparshme, këto ligje konsiderohen si pjesë e legjislacionit anti-korrupsion. Ku sistemi i deklarimeve është kompleks dhe bazohet në dispozita të gjera dhe të hollësishme, miratimi i një ligji të posaçëm mund të jetë alternative e shëndoshë nga pikëpamja e teknikalitetit ligjor. Ligjet e posaçme janë më pak të zakonshme në Evropën Perëndimore.³

Rregullime të posaçme për secilën degë të pushtetit dhe institucionet:

- *Rregulloret e brendshme të parlamenteve dhe kabineteve* – Deklaratat bazuar në rregullat e brendshme janë të zakonshme në legjislatura dhe, në disa vende, në kabinete. Në këto raste, është nisma e ligjvënësit (ose e kabinetit) që të miratojë detyrimin e publikimit të pasurisë për anëtarët e vet, shpesh nën presionin e publikut, me qëllim rritjen e llogaridhënies publike të klasës politike. Shpesh, këto janë rregulla apo procedurë parlamentare, por mund të inkuadrohen në një dokument tjetër. Për shembull, në Gjermani, dispozitat përkatëse gjenden në Shtojcën 1 të Rregullores së Brendshme të Bundestagut. Në Spanjë, deklaratat parashikohen në Urdhrat e Përherëshëm të Kongresit të Deputetëve. Megjithatë, sistemi i përgjithshëm atje është më gjithëpërfshirës dhe bazohet në një sërë ligjesh.
- *Ligjet për degë të caktuara të autoritetit/sectorëve/agjencive* – Zakonisht, ekzistojnë situata ku aplikohet një sistem i veçantë për deklaratat që japin një kategori zyrtarësh publikë, apo për zyrtarë publikë që punojnë në një sektor apo organ të caktuar. Për shembull, sistemi i deklarimit për gjyqtarët mund të jetë i ndryshëm nga ai për zyrtarët publikë të tjerë. Këtë shembull e gjejmë në Federatën Ruse (Ligji për Statusin e Gjyqtarëve në Federatën Ruse, ndryshuar në dhjetor 2008).
- *Rregullat e brendshme*– Nuk është tipike që detyrimi për dorëzimin e deklaratave të parashikohet në rregulloret e brendshme të agjencive ekzekutive. Megjithatë, ndonjëherë miratohen rregulla në agjenci të caktuara si pjesë e masave të kontrollit të brendshëm (p.sh. në administratën tatimore dhe doganore të Kosovës). Dobia në këtë rast është se deklaratat mund të përdoren për qëllime kontrolli nga drejtuesi.

Rregullimi institucional

Analizimi i përvojës ndërkombëtare nxjerr në pah disa alternativa institucionale përmbledhjen dhe përpunimin e deklaratave të zyrtarëve publikë. Këto mund të ndahen në dy kategori të mëdha: rregullimi i brendshëm dhe rregullimi i jashtëm. Alternativa e dytë mund të përdoret për një degë të caktuar të autoritetit, ose të mbulojë të gjithë sistemin shtetëror.

Rregullimi brendshëm përbëhet nga dy lloje kryesore:

- *Titullarët e institucioneve/eprorët/zyrtarët e autorizuar prej tyre* Një nga rregullimet më tipike është procedura ku zyrtarët ua dorëzojnë deklaratat eprorëve të tyre (ose njësitëve të specializuara brenda institucioneve). Eprorët (njësitë) mund të kenë ose jo kompetenca specifike për të verifikuar deklaratat në mënyrë të pavarur. Kjo metodë është më e dobishme kur qëllimi i deklarimit është kontrolli i konfliktit të interesave, sepse eprori ka gjasa të njohë mjaft mirë detyrat e zyrtarit publik dhe nëse një interes privat mund të ndërhyjë në to.⁴ Megjithatë, mund të rezultojë më pak efektive në sistemet ku parandalimi i konfliktit të interesit nuk brendësohet në praktikën e përditshme të administratës publike, ku eprorët nuk kryejnë siç duhet detyrat e tyre menaxheriale.
- *Rregullimi i brendshëm në legjislatura dhe kabinete*. Kjo metodë është më e zakonshme kur nga deputetët (apo personeli parlamentar) kërkohen deklarata të veçanta, si në Bundestagun gjerman, Seanadin dhe Dailin irlandez, Kongresin spanjoll, apo Dhomën e Komunëve dhe Dhomën e Lordëve në Mbretërinë e Bashkuar. Ky rregullim bazohet në parimin se ligjvënësi i ushtron funksionet në mënyrë të pavarur, përfshirë edhe kontrollin dhe penalizimin e anëtarëve të vet (kur

nevojitet). Në pak vende, si në Danimarkë, qeveritë mbajnë regjistra të veçantë për deklaratimet e dorëzuara prej ministrave, bazuar në rregullimin e brendshëm në kabinet.

Rregullimi i jashtëm është më i larmishëm:

Organe/institucione antikorrupsion (kontrolli të konfliktit të interesit) të specializuara për administrimin e deklaratave të zyrtarëve - Rritja e numrit të organeve antikorrupsion të specializuara në rajone të ndryshme është një alternativë tipike për përpunimin e deklaratave të zyrtarëve. Shumë institucione të tilla shpallen të pavarura, por shkalla aktuale e autonomisë ndryshon ndjeshëm. Mandati dhe kompetencat e tyre variojnë, por kjo çështje nuk është në objektin e këtij studimi. Në këto sisteme, deklaratat shihen si mjet kyç antikorrupsion dhe shpesh janë të ndara nga sistemi standard i monitorimit të pasurisë të qytetarëve individualë, si në Kosovë, Mal të Zi, Serbi dhe Slloveni. Një alternativë që haset më rrallë është ngritja e një institucioni të posaçëm që merret vetëm/kryesisht me përpunimin dhe auditimin e deklaratave të zyrtarëve publikë dhe të pasurisë së tyre, si në Shqipëri dhe Rumani.

Autoritetet tatimore—Është praktikë e zakonshme që mbledhja dhe përpunimi i deklaratave të zyrtarëve publikë t'u besohet autoriteteve tatimore, ku të paktën një nga qëllimet është monitorimi i pasurisë. Arsyeja është e qartë: monitorimi i të gjitha të ardhurave, jo vetëm ato të zyrtarëve publikë, është një nga detyrat kryesore të administratës tatimore. Në vende ku zyrtarët publikë janë veçse një kategori e qytetarëve që kanë detyrimin të dorëzojnë deklarata tatimore, organi zbatues është normalisht administrata tatimore, si në Armeni dhe Kazakistan.

Organet e shërbimit civil (shtetëror)—Në vendet me organe të posaçme për të gjithë shërbimin civil (shtetëror), zakonisht janë ato të cilave iu ngarkohet zbatimi i sistemit të deklarimit të zyrtarëve publikë. Mandati i disa prej tyre është i kufizuar vetëm te ekzekutivi; të tjerë mbulojnë edhe ligjvënësin dhe gjyqësorin, të paktën për sa i takon sistemit të administrimit të deklaratave, si në Gjeorgji dhe Kirgizstan.

Organet parlamentare—Ekzistojnë raste ku organet parlamentare mbledhin dhe/ose verifikojnë deklaratat e dorëzuara jo vetëm nga deputetët dhe personeli parlamentar, por edhe nga zyrtarët e degëve të tjera të autoritetit. Për shembull, në Estoni, zyrtarët e lartë dorëzojnë deklaratat pranë komisionit parlamentar. Ky rregullim mund të justifikohet për disa arsye: supozimi se sa më afër ligjvënësit, aq më i lartë është vizibiliteti dhe mbikëqyrja e opozitës, çka e minimizon rrezikun e ndërhyrjeve të paligjshme politike apo të tjera. Për më tepër, deputetët i nënshtrohen zgjedhjeve popullore dhe duhet të japin llogari ndaj publikut më shumë sesa zyrtarët e tjerë kontrollues.

Organet gjyqësore—Kjo alternativë zbatohet në dy variante. Në disa sisteme, gjyqtarët dorëzojnë deklaratat te organe të caktuara që funksionojnë brenda sistemit të gjyqësorit, si në Danimarkë. Edhe pse mund të shihet si shprehje e respektimit të pavarësisë së gjyqësorit, në disa sisteme, organet gjyqësore mbledhin edhe deklaratat e zyrtarëve nga degë të tjera të autoritetit shtetëror, si në rastin e Gjykatës Kushtetuese në Portugali. Meqë kudo prej zyrtarëve gjyqësorë pritet që të demonstrojnë shkallë të lartë paanshmërie politike pavarësie, kjo është një tjetër mënyrë për të parandaluar rrezikun e ndërhyrjeve të paligjshme politike apo të tjera. Një version të kësaj metode e gjejmë në Francë, ku Komisioni për Transparencën Financiare të Jetës Politike përbëhet më së shumti nga zyrtarë të gjyqësorit.

Institucione të tjera - Këto mund të jenë institucione të kontrollit të lartë (Bullgaria dhe dikur Estonia për disa zyrtarë publikë), agjenci ekzekutive të tjera nga institucionet tatimore dhe institucionet e gjendjes civile, etj.

Luhatjet dhe vazhdueshmëria e sistemeve të reja

Futja në përdorim e një sistemi deklarimesh përbën një detyrë komplekse – sidomos kur ky sistem pritet të arrijë qëllime ambicioze dhe të shumëfishta, si kontrolli maksimal i konfliktit të interesit dhe në të njëjtën kohë monitorimi i hollësishëm i pasurive të nëpunësve publikë. Eksperienca tregon se periudha fillestare e zbatimit të sistemeve të deklarimit priret të kalohet me vështirësi. Kjo është edhe më e vërtetë në vende me kapacitete të dobëta administrative dhe mangësi në funksionimin e shtetit të së drejtës.

Versionet e para të sistemeve të deklarimeve shpesh nuk arrijnë të realizojnë qëllimet e shprehura dhe shumë shpejt identifikohen mangësi të shumta. Këto të dytat mund të përfshijnë informacione të pamjaftueshme për tu deklaruar (ose kërkesa për deklarim përmes formularëve të gabuar), organe të dobëta zbatuese, sanksione të pamjaftueshme ose mungesë sanksionesh për mos-respektim të ligjit, procedura të komplikuar për vendosjen e sanksioneve në rast mosrespektim të ligjit, etj.¹³ Atëherë nuk përbën çudi që një karakteristikë tipike e vendeve në tranzicion që kanë miratuar sisteme komplekse deklarimi në vitet 1990 dhe më vonë është që ky sistem ka pësuar një numër të madh ndryshimesh (shpesh madhore).

Sa më poshtë, janë thjesht disa nga këta shembuj. *Ligji Bullgar për Deklarimin Publik të Interesave Financiare të Zyrtarëve të Lartë Publikë* u miratua në vitin 2000 dhe u ndryshua çdo vit në periudhën 2002-2008. Në Lituanë sistemi i deklarimeve u fut në vitin 1998 dhe që atëherë, rregullat janë ndryshuar në vitin 2000, 2005, 2005, dhe 2008.¹⁴ Kosova e futi sistemin e deklarimeve me ligjin “Për Luftën ndaj Korrupsionit” në vitin 2005. Deklarimet u mbledhën për herë të parë në vitin 2007 dhe në të njëjtin vit filloi hartimi i një ligji të veçantë për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të zyrtarëve të lartë. Arsytet e shprehura për nevojën e një ligji të ri janë “zgjjerimi i objektit të ligjit duke rritur numrin e zyrtarëve që janë të detyruar të deklarojnë pasuritë e tyre, duke rregulluar procedurat për deklarimin e pasurive, duke i dhënë mundësinë agjencisë [Kundër korrupsionit] për të kryer kontrollin e origjinës së pasurive dhe jo vetëm duke kontrolluar mënyrën e plotësimit të deklarimeve, si dhe duke përcaktuar sanksione të qarta në rastin e mos-deklarimeve”. Sistemi estonez ka qenë në proces ndryshimi në kohën e këtij studimi (shtator 2009) dhe në parlamentin estonez është paraqitur një projektligj për këtë qëllim. Pyetësori i këtij vendi përmendte mos-efikasitetet e sistemit (gamën e gjerë të zyrtarëve që duhet të bënin deklarime, të dhëna formale, kontroll formal, etj.) si arsye kryesore pas këtyre ndryshimeve. Kjo shërben pjesërisht si një tregues që sistemet e hartuara fillimisht rezultojnë në shumë mënyra me mangësi në momentin e fillimit të zbatimit të tyre.

Përpunimi i Deklarimeve

Administrimi i deklarimeve të nëpunësve publikë lidhet me një sërë funksionesh. Sa më poshtë, është një listë e disave prej tyre:

- hartimi i udhëzimeve për mënyrën se si duhet t'i plotësojnë nëpunësit publikë formularët e deklarimeve;
- mbledhja e deklarimeve;
- kontrolli i deklarimeve të dorëzuara;

- ruajtja e deklarimeve;
- sigurimi i aksesit të publikut në deklarime;
- verifikimi i përmbajtjes së deklarimeve;
- hetimi i shkeljeve të dyshuara, për shembull konflikt interesi ose aktivitet kriminal bazuar në prova që gjenden në deklarime;
- vendosja e sanksioneve.

Këto funksione mund të ndahen në kategori më specifike dhe mund të identifikohen funksione të tjera shtesë. Ndërkohë, jo të gjitha sistemet janë të projektuara në mënyrë të tillë që të garantojnë që të gjitha funksionet e përmendura më sipër, për shembull disa prej tyre nuk ofrojnë akses publik ose nuk verifikojnë përmbajtjen e deklarimeve (të paktën jo në mënyrë proaktive).

Kur dorëzohen formularët e deklarimeve

Tabela e mëposhtme jep një përmbledhje të pyetësorëve të vendeve të ndryshme ku tregohet nëse zyrtarët duhet t'i dorëzojnë deklaratimet në format fizik apo elektronik. Në asnjë prej këtyre vendeve nuk jepet opsioni i dorëzimit elektronik. Duhet theksuar se në disa vende formularët janë të disponueshëm në format elektronik, por ato duhet të printohen dhe të plotësohen në letër. Në këtë tabelë, kolona “Dorëzimi i formularëve elektronikisht” mbulon si mundësinë e futjes së të dhënave në një bazë të dhënash në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu edhe thjesht dorëzimin në një dosje fizike.

Table 6.1. **Paper and electronic submission**

	Submit a paper form	Submit a form electronically	Form available electronically
Albania	X		X
Azerbaijan	X		
Belarus	X		
Bosnia and Herzegovina	X	X	X
Bulgaria	X	X	X
Croatia	X		X
Estonia	X	X	X
Georgia	X		X
Kazakhstan	X	X	X
Kosovo	X		X
Kyrgyzstan	X		
Latvia	X	X	X
Lithuania	X	X	X
Macedonia	X		X
Montenegro	X	X	X
Romania	X		X
Slovenia	X		X
Tajikistan	X		
Ukraine	X		

Pavarësisht ndryshimeve mes këtyre sistemeve, përdorimi i teknologjive të informacionit thuhet se ndikon ndjeshëm në përpunimin e deklarimeve. Argjentina ka përmendur si shembull futjen e formularëve elektronikë të deklarimeve financiare si një element që pati një ndikim të ndjeshëm (shih Tabelën 6.2).

Tabela 6.2

Table 6.2. **The impact of new technology in processing financial disclosure forms (FDF): Argentina**

	1999	2000
Level of compliance	67%	98%
Estimated cost per FDF	USD 70	USD 8
Total number of FDF requested in public scrutiny	66	823
Number of FDFs requested in paper format/through internet	66/-	263/560
Profile of users: press/citizens	43/23	612/211
Conflict of interest files opened for examination	40	331

Source: Raigorodsky, N. (2002), "Can New Technologies Be A Solution? Conflicts of Interest Cases in Argentina", OECD. (Here reproduced from "Managing Conflict of Interest in the Public Service: OECD Guidelines and Country Experiences", OECD, 2003, p. 89.)

Mbledhja

Mbledhja e deklarimeve është veçanërisht e rëndësishëm nëse sistemi i deklarimeve duhet t'i shërbejë qëllimit të tyre. Për mbledhjen e deklarimeve ekzistojnë modele të ndryshme. Shumë sisteme kanë një procedurë kryesore të mbledhjes së deklarimeve nga zyrtarët e zakonshëm publikë, si dhe sisteme të posaçme për kategori specifike zyrtarësh, për shembull për drejtuesit e agjencive që janë edhe vetë përgjegjës për mbledhjen dhe verifikimin e deklarimeve, zyrtarët e shërbimeve të sigurisë, etj.

Verifikimi

Një tjetër funksion po aq i rëndësishëm është edhe verifikimi i plotësisë dhe saktësisë së deklarimeve. Arsyeja kryesore e këtij funksioni nuk është edhe aq arritja e qëllimeve të sistemit *per se* (sidomos nëse konsiderohet kontrolli i konfliktit të interesit dhe jo monitorimi i pasurisë), por ruajtja e integritetit të sistemit të deklarimeve. Nëse zyrtarët publikë e dinë se të dhënat që ata kanë dhënë në deklaratimet e tyre me shumë gjasë nuk kanë për tu verifikuar kurrë, atëherë ekziston rreziku se sistemi mund të akumulojë një masë të madhe informacionesh "të padobishme" që kanë shumë pak lidhje me realitetin. Shqipëria është shembulli, ku fazat e verifikimit janë qartësisht të dallueshme nga njëra-tjetra. Shih pasqyrën më poshtë (Republika e Shqipërisë, 2009)

Përmbledhje e llojeve të ndryshme të kontrollit të deklarimeve në Shqipëri*¹

- përpunimi paraprak:
 - Gabime materiale
 - Plotësim jo-korrekt
 - Përgjigje të gabuara.
- Kontrolli aritmetik dhe logjik:

¹

OECD (2011), *Asset Declarations for Public Officials: A Tool to Prevent Corruption*, OECD Publishing.

<http://dx.doi.org/10.1787/9789264095281-en>

- Saktësia e vlerësimit të pasurive të deklaruara
- Saktësia e burimeve të deklaruara financiare
- Mjaftueshmëria e mbulimit të pasurive me burime të deklaruara
- Ekzistenca e konfliktit të interesave
- Kontrolli i plotë:
 - Verifikimi i saktësisë së të dhënave të përfshira në formularin e deklarimit
 - Justifikimi i pasurive të deklaruara me burimin e krijimit të tyre
 - Identifikimi dhe zgjidhja e çështjeve të konfliktit të interesit

* Informacioni është marrë nga një prezantim i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të Shqipërisë

Sistemi i deklarimit të interesave private në Shqipëri²

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP) është institucion i pavarur, nën kontrollin parlamentar, i ngarkuar me zbatimin e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Shqipëri. ILDKP-ja u bë funksionale në vitin 2003 dhe çdo vit merr afërsisht 4 200 deklarata të interesave private nga zyrtarët e zgjedhur dhe funksionarë publikë të caktuar (ky numër përbën rreth 4% të numrit total të punonjësve në sektorin publik). Përveç këtij deklarimi të përvitshëm, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP-së mund t'i kërkojë çdo personi fizik apo privat të dorëzojë "deklarim me kërkesë", nëse nevojitet për një hetim. Deklaratat dorëzohen edhe para fillimit dhe pas mbarimit të mandatit. Me rreth 45 punonjës dhe buxhet vjetor 92 milion lekë, ILDKP-ja është përgjegjëse për verifikimin e deklaratave, për këshillim në plotësimin e deklaratave siç duhet, si edhe për punë të përgjithshme parandaluese. Udhëzimet se si plotësohet deklarata janë të afishuara në faqen e internetit dhe roli këshillimor i ILDKP-së rritet gjatë periudhës janar-mars, kur zakonisht dorëzohen deklaratat.

Mes të tjerëve, kategoritë e mëposhtme të zyrtarëve dorëzojnë deklaratat e interesave private: presidenti, deputetët e Kuvendit, kryeministri dhe zëvendësi i tij/saj, ministrat dhe zv.ministrat, nëpunësit civilë të nivelit drejtues të lartë dhe të mesëm, prokurorët, gjyqtarët dhe përmbaruesit, si edhe punonjësit tatimorë dhe doganorë që merret drejtëpërdrejt me mbledhjen e të ardhurave Deklarimet përfshijnë edhe bashkëshortin/bashkëshorten ose partnerin e zyrtarit publik. Gjatë verifikimit, mund t'u kërkohej edhe fëmijëve të rritur që jetojnë në të njëjtën familje me zyrtarin publik që të dorëzojnë deklaratë të interesave private. Deklaratat përfshijnë: pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë, pasuritë me vlerë mbi 5 000 USD, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim, vlerën e likuiditeteve, gjendjet në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozita, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, borxhet ndaj personave fizike apo juridikë, në lekë ose në valutë të huaj, të ardhurat personale për vitin nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione, ose çdo veprimtari tjetër, të ardhurat nga licencat dhe patentat, si edhe interesa të tjera private.

²

OECD (2011), *Asset Declarations for Public Officials: A Tool to Prevent Corruption*, OECD Publishing. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264095281-en> Fighting Corruption in Eastern Europe and Central Asia, Asset Declarations for Public Officials

Deklaratat janë në dispozicion të publikut, por jo *online*, me përjashtim të dy faqeve të fundit të cilat përmbajnë informacion konfidencial që është vetëm për përdorimin e ILDKP-së.

Hetimet mund të fillojnë:

1. me marrjen e një ankese
2. rutinë
3. për shkak të diferencave të mëdha mes pasurive të deklaruara dhe burimeve të ligjshme të të ardhurave
4. për shkak të diferencave mes deklarimit dhe realitetit (stilit të jetesës)
5. për shkak të një auditi të plotë që kryhet periodikisht për poste publike të caktuara

Për qëllime të hetimit, ILDKP-ja ka akses në sa më poshtë:

- regjistrat tatimorë;
- regjistri i tokës;
- baza e të dhënave e Njësisë së Inteligjencës Financiare (NjIF);
- regjistri i mjeteve motorike;
- regjistri i pronave të paluajtshme;
- regjistrat e bankave;
- regjistrat e Qendrës Kombëtare për Regjistrimin e Biznesit;
- regjistrat e Qendrës Kombëtare të Licencave dhe Patentave.

Për verifikimin e deklarimeve, ILDKP-ja përdor mekanizmat e mëposhtëm:

- përpunimin paraprak: identifikohen gabimet e mundshme, përgjigjet e gabuara dhe plotësimi i pasaktë i deklaratave.
- kontrollin aritmetik dhe logjik për qëllime të verifikimit:
 - saktësia e vlerësimit të pasurive të deklaruara;
 - saktësia e burimeve financiare të deklaruara;
 - masa se sa burimet e deklaruara të të ardhurave mund të justifikojnë pasuritë e përfutuara;
 - ekzistenca e konfliktit të interesave.
- Kontrolli i Plotë synon:
 - verifikimin e saktësisë së përgjithshme të të dhënave që përmban deklaratat;
 - verifikimin e masës sipas të cilës pasuritë janë përfutur ligjërisht;
 - identifikimin dhe zgjidhjen e situatave të konfliktit të interesave.

Për vitin 2008, të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë punën e ILDKP-së:

- janë dorëzuar afërsisht 4 200 deklaratat;
- 11 zyrtarë nuk dorëzuan deklaratat;
- 11 zyrtarë u gjobitën për mosdeklarim, 70 për dorëzim të vonuar dhe 2 për deklarim të rreme. Në 66 raste janë identifikuar konfliktet e interesave dhe shkelje të tjera të ligjit

Zbatimi i elementëve të mësipërm të verifikimit kërkon kompetenca të mjaftueshme të agjencisë kontrolluese. Mes këtyre kompetencave të rëndësishme janë këto të drejta:

- Akseson dokumente/të dhëna të institucioneve të tjera publike – tatimet, pasuritë e paluajtshme / tokat, mjetet motorike dhe regjistrat e tjerë, bazat e të dhënave e NjIF dhe të gjendjes civile, etj. Megjithatë, shkalla e aksesit ndryshon nga shteti në shtet. Për shembull, në Slloveni, organi kontrollues që është Komisioni për Parandalimin e

Korrupsionit ka nënshkruar marrëveshje me organet e tjera publike, si p.sh. me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave pranë Ministrisë së Financave, sipas të cilës komisionit duhet t'i dorëzohet pa vonesa informacion për zyrtarët publikë.¹¹ Edhe pse pamundësia e aksesimit të të dhënave nga regjistrat e ndryshëm publikë përmendet shpesh si problem për agjencitë që zbatojnë sistemet e deklarimit, kjo mënyrë bashkëpunimi mund të cilësohet si praktikë e mirë.

- Akseson të dhënat e bankave (shih Tabelën 6.3) dhe të subjekteve të tjera tregtare. Siç shihet në tabelë, në një sërë vendesh ish-socialiste, institucionet kontrolluese kanë akses të drejtëpërdrejtë në informacionin bankar në lidhje me zyrtarët publikë, por njëkohësisht shumë sisteme nuk e ofrojnë këtë akses, ose e japin vetëm me urdhër gjyqate. Sistemet janë të shumëllojshme; për qëllime verifikimi, të dhënat për mjetet financiare në llogaritë bankare të zyrtarëve publikë janë qartësisht po aq të rëndësishme sa të dhënat e regjistrave të taksave, për shembull.

Kërkon shpjegime nga zyrtarët publike deklarues apo persona të tjerë:

- Kërkon kryerjen e verifikimeve nga institucione të tjera, p.sh. administrata tatimore (p.sh. shih më lart shembullin e Bullgarisë).
- Kërkon opinion ekspert.

Serbia

Divizioni i Regjistrave është pjesë e Departamentit të Mbikëqyrjes së Pasurive dhe Të Ardhurave të Zyrtarëve dhe ushtron këto detyra: merr njoftimet e zyrtarëve publike që marrin funksione publike dhe kur u mbaron mandati i funksionit; kontrollon respektimin e afateve dhe kërkesat formale të deklaratave, arkivimin dhe mirëmbajtjen e tyre; mban regjistrin e zyrtarëve publikë; mban regjistrin e deklaratave të pasurive të zyrtarëve publikë dhe palëve të lidhura sipas kuptimit të nenit 43 të Ligjit për Autoritetin e Kontrollit të Pasurive (AKP); të dhënat e subjekteve juridike ku zyrtari publik zotëron mbi 20% të aksioneve; mban regjistrat e dhuratave; publikon dhe përditëson në faqen e internetit të AKP-së të dhënat e pasurive të zyrtarëve publikë; merr njoftimet për transferimin e të drejtave të menaxhimit dhe të dhënat e personave tek të cilët transferohen të drejtat; monitoron transferimin e të drejtave të menaxhimit te shoqëri tregtare ku zyrtarët publikë zotërojnë mbi 3% të aksioneve. AKP-ja gëzon të drejtën të hapë çështje disiplinore administrative dhe penale.

Në mbështetje të të gjitha veprimtarive të veta, AKP-ja ka një sektor të zhvilluar të teknologjisë së informacionit (TI), i cili mundëson krijimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e regjistrave që sigurojnë ushtrim më efikas të mandatit dhe kompetencave të AKP-së. Kjo ka bërë të mundur edhe forcimin e rolit kontrollues të AKP-së, e cila ka filluar të zhvillojë më intensivisht metodat e hetimit administrativ.

Letonia

Byroja e Parandalimit dhe Luftës kundër Korrupsionit (KNAB) është ngritur në tetor 2002 dhe u bë plotësisht funksionale në shkurt 2003. KNAB-i raporton te Qeveria e Republikës së Letonisë (Kabineti i Ministrave). Letonia miratoi një ligj që kombinonte krijimin e KNAB-it dhe rregullimin ligjor të parandalimit të korrupsionit: Ligji për duke kombinuar krijimin e KNAB-it dhe duke rregulluar parandalimin: Ligji për Byronë e Parandalimit dhe Luftës kundër Korrupsionit (KNAB). Përveç Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit, KNAB-i ka mandatin të

zbatojë Ligjin për Financimin e Organizatave Politike³ dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesave të Zyrtarëve Publikë⁴

1. KNAB-i ka tagrin për hetimin dhe parandalimin e korrupsionit. Ky institucion zbaton katër detyra kryesore:
2. Hetimi i Korrupsionit: kryen hetime administrative, vendos sanksione (Kodi i Procedurës Administrative të Letonisë; mbledh inteligjencë (informacion operativ) penale; kryen hetime paraprake (Ligji i Procedurës Penale); ka akses në informacion (përfshirë informacionin bankar) dhe akses në ambiente.
3. Parandalimi i Korrupsionit: harton strategjinë për parandalimin e korrupsionit dhe planin kombëtar të veprimit; kontrollon dhe monitoron programin kombëtar antikorrupsion; parandalimin e konfliktit të interesave në veprimtarinë e zyrtarëve publikë; ankesat e qytetarëve; analizon prirjet e korrupsionit dhe jep rekomandime për parandalimin e korrupsionit në institucionet publike; përgatit metoda për parandalimin dhe luftën e korrupsionit në institucionet publike dhe në sektorin privat; analizon dhe harton akte ligjore; organizon anketa të opinionit publik; i jep publikut informacion periodik për prirjet e korrupsionit, rastet e zbuluara dhe hapat e ndërmarrë në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit; si edhe ofron trajnim antikorrupsion.
4. Kontrolli i financimit të partive politike dhe deklaratave të pasurive të zyrtarëve publikë;
5. Edukimi mbi parandalimin e korrupsionit, ligjin dhe etikën. Përveç dy funksioneve kryesore - parandalimin dhe hetimin – KNAB është përgjegjës edhe për edukimin dhe informimin e shoqërisë. Kjo po bëhet pjesë gjithnjë e më e rëndësishme e punës së KNAB-it, që është përgjegjës për edukimin e publikut në fushat e respektimit të ligjit dhe etikës. KNAB është ngarkuar edhe me informimin e publikut mbi prirjet e korrupsionit, rastet e korrupsionit të zbuluara, si edhe masat e ndërmarra për parandalimin e korrupsionit dhe zbatimin e ligjit.⁵

Polonia

Byroja Qendrore kundër Korrupsionit (CBA) është organi kryesor antikorrupsion në Poloni. CBA-ja është krijuar në vitin 2006 me Aktin datë 9.06.2006⁶. CBA-ja është agjenci e veçantë që lufton korrupsionin në sektorin publik dhe privat, duke u dhënë përparësi institucioneve shtetërore dhe të qeverisjes vendore, si dhe luftës kundër korrupsionit që mund të vërë në rrezik interesat ekonomike të shtetit. Polonia nuk ka një ligj të posaçëm kundër korrupsionit. CBA-ja është fort e centralizuar nën mbikëqyrjen e Kryeministrit/Qeverisë si dhe raporton te Parlamenti, Kryeministri dhe Presidenti.

Byroja është i vetmi shërbimi i veçantë që ka instrumentin - në formën e kontrollit të deklaratimeve të pasurive dhe vendimeve ekonomike. Qëllimi i veprimtarive kontrolluese të që kryejnë nëpunësit e CBA-së është zbulimi i rasteve të korrupsionit në institucionet publike,

³ Law on Financing Political Organizations Adopted on June 6, 1992, last amended in September 2008

⁴ Law on Prevention of Conflict of Interest of Public Officials, Adopted on May 8, 2003; last amended in February 13 2014

⁵ Education of public officials and the society about corruption, ethics and respect of law
<http://www.knab.gov.lv/en/education/>

⁶ Act of 9 June 2006 on the Central Anti-Corruption Bureau -Journal of Laws of 2014, item 1411 – consolidated text (pdf 778.03 KB)

shpërdorimi i personave që ushtrojnë funksione publike dhe veprimtaritë kundër interesit ekonomik të Shtetit. Kontrollat kryhen në bazë të planit vjetor të kontrollit, të miratuar nga titullari i CBA-së, ose mbi bazë *ad hoc* kur është e nevojshme.

Veprimtaritë kontrolluese konsistojnë në:

1. zbulimin dhe parandalimin e rasteve të shkeljeve, p.sh. me objekt miratimin e vendimeve ekonomike (ndër të tjera: privatizimi, mbështetja financiare, asgjësimi i pasurive shtetërore dhe bashkiake, prokurimi publik);
2. verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratave të pasurive ose deklaratave për kryerjen e veprimtarive ekonomike nga personat që ushtrojnë funksione publike.

Rumania

Autoritetet rumune rendisin këto arsye për ngritjen e këtij regjimi:

- zbatimi i politikës së konfliktit të interesit;
- rritja e besimit të publiku dhe llogaridhënies;
- respektimi i kërkesave ndërkombëtare;
- në kuadrin e proceseve të bashkëpunimit me BE-në;
- transparenca në ushtrimin e funksioneve publike;
- zbatimi i regjimit juridik të mospërputhjeve;
- përmirësimi i shkallës së luftës kundër korrupsionit përmes mjeteve administrative.

Deklaratat e pasurive u futën fillimisht në tetor 1996 dhe janë përmirësuar gradualisht që prej asaj kohe. Në fillim, deklaratat nuk bëheshin; në vitin 2003, ato u bënë publike, por përmbajtja e formës u reduktua ndjeshëm, ndërsa në vitin 2005 modelet u ndryshuan përsëri për të përfshirë të gjithë informacionin përkatës. Legjislacioni i vitit 2005 sanksionoi qartë se deklaratat janë dokumente publike. Gjatë gjithë kësaj periudhe, ka pasur vazhdimisht kontestime rreth çështjes së publikimit të pasurisë, si një temë ishte jashtëzakonisht e ndjeshme, së bashku me financimin e partive politike dhe zbulimin e veprimtarisë së shërbimit të sigurimit gjatë komunizmit. Presioni i vazhdueshëm i aktorëve të jashtëm, si Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, i kombinuar me kërkesat në rritje për transparencë nga shoqëria civile, e ka vënë çështjen e publikimit të pasurisë dhe interesave në axhendën e autoriteteve rumune. Përparimi më i qenësishëm në këtë drejtim u shënuar në periudhën 2005-2007, kur Rumania po përgatitej për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Me përfundimin e negociatave në vitin 2004, u miratua një dokument qëndrimi të përbashkët për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme, ku renditeshin fushat në të cilat Rumania duhej të bënte përparim të mëtejshëm. BE-ja e ka përshëndetur deklarin e pasurive dhe interesave, por ka theksuar për një mekanizëm efikas që mundëson zbatimin e sanksioneve parandaluese. Përveç kësaj, GRECO (Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit) rekomandoi në vitin 2005 "që të ngrihet një sistem efektiv për mbikëqyrjen e deklaratave të pasurive dhe interesave". Në maj 2007 u miratua ligji për ngritjen e **Agjencisë Kombëtare të Integritetit (NIA)**. NIA është një organ i pavarur administrativ me kompetencë të pakufizuar për gjyqësorin, ekzekutivin dhe ligjvënësit, i cili verifikon deklaratat e pasurive, deklaratat e interesave dhe respektimin e regjimit të mospërputhjeve. Me kërkesë të qeverisë, parlamenti i pakësoi kompetencat e NIA-s, por edhe në këtë version më të butë, miratimi i ligjit pati shumë polemika. U zhvilluan debate të ndezura rreth kompetencave të NIA-s, ku shumë deputetë ishin kundër kontrollit të pasurisë së pajustificuar që rezultonte nga deklarimi i pasurisë. Argumenti ishte se legjislacioni penal dhe administrativ e kushton konfiskimin me

paraqitjen e provave që vërtetojnë se pasuria është përfutur si rezultat i kriminalitetit apo shkeljeve, apo është përdorur në lidhje me to; nga ana tjetër, ligji për NIA-n e lejon konfiskimin, nëse zyrtari publik nuk arrin të justifikojë rritjen e ndjeshme të pasurisë së vet gjatë ushtrimit të detyrës. Në fund, ligji lejon konfiskimin e pasurive të pajustificuara, por mjetet në duart e inspektorëve të NIA-s për kryerjen e verifikimeve nuk janë aq të fuqishme sa ç'u parashikua fillimisht. Një tjetër debat, të cilin e zgjidhi qeveria para dërgimit të projektaktit në parlament, kishte të bënte me përkufizimin e konfliktit të interesave. Projektakti fillestar përfshinte një përkufizim të gjerë në kuadrin e të drejtës administrative, duke pasur parasysh se Kodi Penal e përmban veprën penale të konfliktit të interesit. Gjithsesi, vendimi përfundimtar ishte kufizimi i përkufizimit të konfliktit të interesave në bazë të të drejtës administrative – deri te të afërmit e rrethit të parë, që është objekt më i ngushtë sesa përkufizimi i të drejtës penale, ama, përfshinte edhe përfitimet jopasurore. Objekti i mospërputhjeve qëndron i pandryshuar dhe është parashikuar kryesisht në Ligjin 161/2003 dhe aktet nënligjore të miratuara për zyrtarë publikë të ndryshëm.

Polemikat rreth miratimit të ligjit vazhduan për disa muaj, kur Agjencia pati vështirësi në sigurimin e buxhetit dhe të ambienteve për selinë e vet. Vështirësitë kryesore në ngritjen e Agjencisë ishin:

- mungesa e ambienteve të përshtatshme të punës;
- mungesa e vullnetit politik për ta konsoliduar Agjencinë;
- mangësitë legjislative;
- kohëzgjatja e madhe e procedurave të prokurimit publik;
- personeli i pamjaftueshëm;
- pagat e ulëta për inspektorët e integritetit;
- reagimi i qeverisë ndaj krizës ekonomike që pati ndikim negativ në rekrutimin e punonjësve të rinj.

Detyrat kryesore të NIA-s janë:

- mbledhja e deklaratave;
- ruajtja e deklaratave
- garantimi i aksesit publik në deklarata;
- kontrolli i dorëzimit të deklaratave;
- hartimi i udhëzimeve për zyrtarët publikë se si të plotësojnë formularët e deklarimit;
- dhënia e këshillave sipër kërkesës për zyrtarët publikë;
- verifikimi i përmbajtjes së deklaratave;
- dorëzimi i dosjeve në gjykatë me propozimin për vendosjen e sanksioneve në rast mosrespektimi të deklarimit të pasurive, konflikti të interesave dhe regjimit të mospërputhjeve;
- njoftimi i organeve të hetimit penal për shkeljet që mund të përbëjnë vepër penale;
- hartimi i studimeve dhe analizave, si edhe mbledhja e statistikave vjetore.

Kompetencat e NIA-s janë:

- aksesimi i dokumenteve/të dhënave që mbajnë autoritetet publike;
- e drejta për të kërkuar shpjegime nga zyrtarët deklarues apo persona të tjerë;
- e drejta për të kërkuar opinion ekspertit me pëlqimin paraprak të personit nën verifikim;
- e drejta për të gjobitur zyrtarin publik në fjalë.

Qasja në baza të dhënash dhe verifikimi

Agjencia Kombëtare e Integritetit (NIA)⁷ është themeluar me Ligjin Nr. 144, prej vitit 2007.⁸ NIA është një autoritet administrativ i pavarur, me personalitet juridik, që operon në nivel lokal, me strukturë unike dhe seli në Bukuresht. Roli i NIA-s është të verifikojë deklaratat e pasurisë e të interesit, të kontrollojë plotësimin në kohë të deklaratave, të vlerësojë mos zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me konfliktin e interesave, papajtueshmërinë e pasurisë dhe të formulojë ankesat për organet hetimore penale. NIA kryen llojin administrativ të hetimeve dhe i nënshtrohet kontrollit gjyqësor.

NIA ka akses në të gjithë dokumentat/regjistrat e autoriteteve publike apo cdo entiteti publik o privat (regjistra tatimorë, bazat e të dhënave me ID-të personale, regjistri i automjeteve, regjistri i pasurive të paluajtshme, regjistri i tokës etj). Agjencia performon verifikime sipas detyrës zyrtare apo pas njoftimit nga cdo person individual apo juridik. Vlerësimi i pasurisë, konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë së të dhënave realizohet gjatë mandatit publik të zyrtarit dhe tre vite pas përfundimit të tij.

Veprimtaria operative realizohet nga inspektorët e integritetit nëpërmjet sistemit informatik të menaxhimit të integruar të deklaratave të pasurisë e interesave (SIMIDAI).⁹ Ky sistem ka një sërë modulesh operacionale duke përfshirë modulën e alokimit të rastësishëm, modulën për analizën e të dhënave, monitorimin e dokumenteve, statuseve, listë për kontrollin e hetimeve, paralajmërim të hershëm, modulën e monitorimit, auditimit, regjistrat etj. SIMIDAI përbën prioritet strategjik të Agjencisë dhe synon përmirësimin e nivelit operativ të punës së inspektorëve të integritetit.

Portali i deklaratave të pasurive dhe interesave (<http://deklarati.integritate.eu>) ka 3 570 323 deklarata.¹⁰

NIA kryesohet nga një President, Nënkyetar dhe Sekretar i Përgjithshëm, ka 83 punonjës dhe 117 pozicione të lira. Buxheti final për vitin 2011, i miratuar nga parlamenti ishte 2 milionë Euro¹¹. Deklaratat dorëzohen cdo vit – jo më vonë se data 15 Qershor për vitin fiskal paraprak; brenda 15 ditëve të fillimit dhe përfundimit të mandatit; dhe në rastet e kandidaturave në zgjedhje, brenda 15 ditëve nga emërimi apo zgjedhja në funksionin publik ose nga fillimi i veprimtarisë.

Deklaratat dorëzohen manualisht në letër; ato duhet të dërgohen në kopje origjinale e të përfshijnë nënshkrimin e zyrtarit publik. Deklaratat mblidhen nga personat e caktuar përgjegjës në cdo institucion, të cilët bëjnë një kontroll paraprak të tyre dhe informojnë zyrtarin publik në rast të identifikimit të parregullsive, duke lejuar ri-dorëzimin e deklaratave. Më pas deklaratat i dërgohen NIA-s dhe publikohen në faqet zyrtare të institucioneve respektive (informacioni duhet të qëndrojë online për 5 vite). Në këtë mënyrë deklaratat janë

⁷ www.mvr.bg/.../11_presentation_Romania.p...

⁸ Low on the establishment, organization and functioning of the National Integrity Agency, as amended by Government Emergency Ordinance no. 49/2007

⁹ Sistemul Informatic de Management Integrat al Declarațiilor de Avere și de Interese - S.I.M.I.D.A.I.
https://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/WorkingGroups/workinggroup4/2012-August-27-29/Responses_NVs_2012/20120417_Romania_English.pdf

¹⁰ Promoting *Transparency and Accountability in Public Institutions*, **IMPLEMENTING THE INTEGRITY CONCEPT**

Silviu Ioan POPA, Advisor to the President National Integrity Agency, Republic of Romania

¹¹ https://www.unodc.org/documents/corruption/WG-Prevention/Art_6_Preventive_anti-corruption_bodies/Romania.pdf

tërësisht publike. Formularët e deklaratave që duhen plotësuar janë të disponueshme si në versionin letër ashtu dhe elektronikisht (mund të shkarkohen nga interneti). Gjithashtu, ekzistojnë manuale online (në faqen e NIA-s) për mënyrën e plotësimit të tyre, që mund t'i vijnë në ndihmë zyrtarëve publikë. NIA mund të ofrojë edhe asistencë ligjore sipas kërkesave.

Për të kontrolluar dhe publikuar deklaratat e pasurisë dhe interesave, NIA ka implementuar një sistem elektronik për administrimin e dokumentave të marrë në dorëzim në formatin origjinal (letër). Deklaratat skanohen dhe vendosen në sistemin e menaxhimit të të dhënave, i cili ja ofron këtë informacion edhe publikut të gjerë në <http://deklaratii.integritate.eu/>. Informacioni mund të gjendet në format PDF dhe kërkimi mund të realizohet duke përdorur kriteret në vijim: emri i zyrtarit publik, institucioni publik, pozicioni i zyrtarit publik, vitin kur deklarata është dorëzuar dhe tipi i deklaratës (deklaratë pasurie apo interesi). Përveç pjesës së publikut, sistemi për menaxhimin e të dhënave mund të përdoret edhe nga inspektorët për verifikime; krahas procesit të skanimit të deklaratave, të dhënat ekstrahohen dhe vendosen në një bazë të dhënash të vecantë për përdorim të brendshëm të NIA-s. Një sistem i sofistikuar i menaxhimit të të dhënave është duke u zhvilluar, për të bërë sa më efektiv procesin e verifikimit. Ky instrument është thelbësor duke patur parasysh numrin e lartë të deklaratave të dorëzuara: në Janar 2010, NIA ka marrë 503 000 deklarata (185 114 në 2007 dhe 317 886 në 2008). Në mes të 2010-s u morën rreth 1.6 milionë deklarata si pasojë e sistemit të menaxhimit të të dhënave.

Sanksionet

Verifikimet e deklaratave të pasurive dhe interesave, si dhe të situatave të mundshme të papajtueshmërisë, mund të iniciohen si pasojë e:

- marrjes së ankesave (nga ankesat e marra, janë verifikuar deklaratimet e 921 zyrtarëve publikë)
- vendimin e presidentit të NIA-s bazuar në informacionin e marrë, për shembull nga raportet e medias (si pasojë e vendimit të presidentit të NIA-s, janë verifikuar 3667 zyrtarë publikë). Mos dorëzimi apo dorëzimi me vonesë i deklaratave nis automatikisht procedurën e verifikimit – në këtë situatë vendimi formal për fillimin e procedurës së verifikimit merret edhe nga presidenti i NIA-s.

Gjeorgjia

Që nga viti 2010, Gjeorgjia ka një sistem të plotë online për plotësimin, dorëzimin dhe publikimin e deklaratave të pasurisë për mbi 3000 zyrtarë të lartë publikë. Deri tani, verifikimi i vërtetësisë së të dhënave të publikuara ka qenë subjekt i shqyrtimit të publikut. Për këtë arsye, Qeveria po planifikon krijimin e një mekanizmi administrativ për verifikimin e tyre.

Procedura e verifikimit – aspekti financiar – një procedurë verifikimi përbëhet nga fazat e mëposhtme:

- Kontrolli i dorëzimit - „A është dorëzuar deklarata nga zyrtari?“
- Kontrolli formal - „A janë plotësuar të gjitha fushat e nevojshme të deklaratës?“
- Kontrolli i besueshmërisë - „A janë të dhënat e deklaruara koherente?“
- Auditimi - „A ka fshehur zyrtari ndonjë të ardhur apo pasuri?“

Byroja e Shërbimit Civil verifikon dorëzimin e të dhënave. Në një farë mase ajo realizon gjithashtu edhe kontrollin formal, gjë që mundëson udhëzimin e zyrtarit për të dhënat që duhet të plotësojë në secilën fushë. Kontrolli i besueshmërisë mund të kryhet nga një kompjuter: cdo vit një program kompjuterik llogarit nëse shpenzimet e deklaruara janë apo jo më të larta se të ardhurat e deklaruara. Ky kontroll mund të realizohet për të gjithë zyrtarët publikë. Auditimi ka për qëllim të përdorë të gjitha metodat e mundshme për të zbuluar parregullsitë financiare që mund të gjenden në deklaratat e një zyrtari. Auditimi kërkon që një ekspert financiar të kontrollojë bazat shtetërore të të dhënave (për shembull regjistrin e pasurive të paluajtshme, tatimet etj). Një auditim efektiv kërkon gjithashtu kontrollin e të dhënave bankare dhe ndonjëherë të kërkohej informacion nga subjekte private lidhur me financat e zyrtarit publik. Duke pasur parasysh që kjo procedurë kërkon kohë, në auditim mund të kalojë cdo vit një përqindje shumë e vogël e zyrtarëve publikë (5-10%). Kriteret e përzgjedhjes:

- ankesat e vërtetuara individuale (përfshirë edhe ato anonime)
- raportet mediatike
- përzgjedhje rastësore
- flamuj të kuq (duke përfshirë problematika në kontrollin e besueshmërisë)

Procedura e verifikimit – aspekti i konfliktit të interesit – Sa i përket vërtetësisë së deklaratës, aspekti i konfliktit të interesit përfiton plotësisht nga verifikimi financiar: cdo e ardhur apo pasuri e fshehur, nga e cila mund të lindë konflikti i interesit, duhet të zbulohet gjatë auditimit. Sa i përket përputhshmërisë me rregullat e konfliktit të interesit, ligji duhet të përcaktojë eprorët që duhet të jenë përgjegjës për verifikim. Organi kompetent mbikëqyrës – vetëm auditimi do të kërkojë kompetenca dhe burime të reja të konsiderueshme. Ekzistojnë tre opsione të mundshme:

- Në kompetencat e Byrosë së Shërbimit Civil do të përfshihet auditimi
- Byroja e Shërbimit Civil do të bashkëpunojë me administratën tatimore për auditimet
- Shërbimi i të Ardhurave Tatimore do të jetë i vetmi përgjegjës për pranimin dhe verifikimin e deklaratave të pasurisë.

Ndryshimet rregullative – kjo ka të bëjë kryesisht me ligjin që rregullon organin mbikëqyrës, me nevojën për të përcaktuar në vecanti kompetencat gjatë një auditimi dhe të drejtat e zyrtarëve publikë, familjarëve të tyre dhe palëve të treta të përfshira.

Burimet njerëzore dhe IT – Në varësi të shkallës së dëshiruar të auditimeve dhe duke marrë parasysh shkallën e lartë të digjitalizimit në Gjeorgji, duhet të jenë të mjaftueshëm dy analistë financiarë. Baza e të dhënave do të ketë nevojë për disa ndryshime në softuer për kryerjen e kontrolleve automatike.

Sipas Neneve 4 dhe 15 të Ligjit mbi Konfliktet e Interesit, deklaratimet duhet të përfshijnë informacione mbi anëtarët e familjes (bashkëshorti/ja, fëmijët e mitur dhe nipërit/mbesat, personat që jetojnë me zyrtarët publikë). Forma e deklaratimit kërkon informacion financiar mbi:

- të ardhurat në fomë kesh
 - të ardhurat nga aktivitete të paguara (paga, bonuse etj) > 0 GEL
 - të ardhurat nga veprimtari sipërmarrëse > 0 GEL
 - Dhuratat e marre > 500 GEL – 300 USD

- Kontrata (hua të marra etj) > 1,500 GEL – 2000 USD
- cdo fitim > 1,500 GEL
- Llogaritë bankare (cdo shumë parash në to) > 0 GEL
- Pasuritë e paluajtshme (shtëpi, tokë) > 0 gel
- Pasuri të luajtshme (makina, bizhuteri, piktura etj) > 10,000 GEL
- Kontrata (huatë e dhëna, dhurata të dhëna etj) > 1,500 GEL
- Kesh > 4,000 GEL
- Cdo humbje > 1,500 GEL

Në këtë mënyrë, sistemi i deklarimit shërben për një qëllim të dyfishtë: lejon verifikimin e gjendjes financiare të zyrtarit publik („A ka të ardhura të paligjshme?“) dhe konfliktet e mundshme të interesit („A ka interesa biznesi në konflikt me detyrat e punës së tij/saj?“).

Afat për dorëzimin e deklaratave janë:

- brenda dy muajve pas emërimit
- cdo vit
- brenda dy muajve pas largimit

Për kandidatët në zgjedhjet parlamentare, zbatohet afati për regjistrimin brenda 7 ditëve. Byroja e Shërbimit Civil dërgon njoftime lidhur me afatet e dorëzimit të deklaratave me postë, postë elektronike e mesazhe telefonike.

Slovenia

KPK – Byroja hetuese dhe mbikëqyrëse kryen hetime për rastet e korrupsionit, konfliktit të interesit, shkeljeve të rregullave të lobimit dhe shkeljeve të tjera që janë nën juridiksionin e KPK-së. Kjo njësi është gjithashtu përgjegjëse për mbledhjen dhe monitorimin e deklaratave të pasurive të zyrtarëve të lartë publikë, në zbatim me rregullat e konfliktit të interesit; mirëmbajtjen e regjistrit qendror të lobuesve; mbrojtjen e bilbilfryrësve dhe bashkëpunimin operacional me organet e zbatimit të ligjit dhe prokuroritë.¹²

Maqedonia

SCPC mbledh formularët e deklarimit të pasurisë, përditëson regjistrin dhe publikon të dhënat në faqen zyrtare të internetit. Ky institucion gjithashtu mbledh deklaratat e interesit, duke dhënë më pas opinion mbi konfliktin e interesit të zyrtarëve. Regjistri i deklaratave të pasurisë është i ndërtuar mirë, i përditësuar e transparent si dhe lehtësisht i aksesueshëm e me filtra kërkimi të detajuar për publikun.¹³ Megjithatë, ai nuk ka një listë të plotë të zyrtarëve shtetërorë dhe nuk ka akses në bazat e të dhënave të agjencive të tjera shtetërore, për të kontrolluar vlefshmërinë e deklaratave. Për validimin e deklaratave të pasurive, SCPC-ja bashkëpunon me Zyrën e të Ardhurave Tatimore. Zyrtarët janë të detyruar të dorëzojnë deklarimet e tyre të pasurive tek të dy këto institucione dhe Zyra e të Ardhurave Tatimore është përgjegjëse për kontrollin e vërtetësisë së të dhënave të deklarimeve.

Njësia për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit merret me korrupsionin në politikë, në rradhët e zyrtarëve publikë dhe në sektorin ekonomik e privat. Kjo njësi është

¹² <https://www.kpk-rs.si/en/enforcement>

¹³ http://dksk.org.mk/imoti_2/

gjithashtu përgjegjëse për mbledhjen dhe monitorimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë publikë, zbatimin e rregullave mbi konfliktin e interesit dhe mirëmbajtjen e regjistrave me deklaratat e konfliktit të interesit dhe ato të pasurisë. Ajo ka 11 punonjës, të cilët duhet të merren me 4000 deklaratat pasurish e me po të njëjtin numër deklaratash të konfliktit të interesit. Numri i zyrtarëve publikë nuk është njihet. Maqedonia ka 80 njësi administrative dhe më pak se 2 milionë banorë.

U4¹⁴ - Përdorimi i Teknologjisë për menaxhimin e pajtueshmërisë së të dhënave

Për menaxhimin e pajtueshmërisë së të dhënave, organi mbikëqyrës duhet të realizojë një numër detyrash, të cilat mund të automatizohen deri në njëfarë mase (Banka Botërore 2012):

- krijimi dhe menaxhimi i një regjistri me zyrtarët që janë të detyruar të plotësojnë deklaratat e pasurive, ku të përfshihet numri dhe identiteti i zyrtarëve, pozitat e tyre dhe zhvillimi i karrierës me kalimin e kohës, si dhe njoftimi i zyrtarëve për të dorëzuar brenda afatit deklaratat
- zhvillimi i formave të plotësimit e dorëzimit të deklaratave, në disa raste edhe formate online
- marrja e deklaratave dhe shqyrtimi fillestar formal për plotësimin dhe konsistencën e informacionit të deklaruar
- kontaktimi i zyrtarëve për të plotësuar apo sqaruar më tej deklaratat jo të plota
- transferimi i të dhënave nga deklaratat në baza të dhënash për të lehtësuar tërheqjen e informacionit, verifikimin, gjurmimi i të dhënave dhe publikimi i tyre
- sigurimi i të dhënave dhe lehtësia e tërheqjes së informacionit të deklaruar

Procesi i Dorëzimit

Sistemet manual të dorëzimit të deklarimeve rezultojnë në numër më të madh të deklaratave të plotësuara me gabime (Hoppe 2014). Plotësimi dhe dorëzimi elektronik i deklaratave të pasurive mund të jetë i dobishëm për të zhvilluar një sistem që bën të mundur që informacioni të jetë në një format të editueshëm si dhe të përdorë terminologji të standardizuar për të lehtësuar validimin dhe analizën e të dhënave. Për më tepër, në sistemet plotësisht të automatizuara, dorëzimi i një deklarate të paplotë mund të mos lejohet, duke mos i dhënë mundësinë zyrtarëve të dorëzojnë deklaratën me fusha të pa plotësuara. Sistemi mund të mundësojë mbështetje edhe për plotësimin e deklaratës, duke lejuar plotësimin e kategorive vetëm me gamë vlerash të pranueshme për to, si në rastet e Letonisë dhe Argjentinës. Disa vende, si Letonia, plotësojnë paraprakisht formularët e deklaratave me të dhëna personale që i tërheqin nga baza të dhënash ekzistuese, sic për shembull informacioni i tatimeve. Dorëzimi elektronik lejon gjithashtu monitorimin e pajtueshmërisë së të dhënave dhe lehtësi për të kontrolluar nëse të gjithë zyrtarët e kanë realizuar këtë detyrim brenda afatit të kërkuar, apo jo.

¹⁴

The use of technology for managing income and asset declarations <https://www.u4.no/publications/the-use-of-technology-for-managing-income-and-asset-declarations.pdf>

Sistemet për menaxhimin e të dhënave

Pavarësisht nëse deklaratat janë dorëzuar manualisht apo në mënyrë elektronike, organi mbikëqyrës duhet të transkribojë të dhënat nga një kopje fizike në një program për menaxhimin e bazës së të dhënave. Ai duhet të zhvillojë apo të prokurojë një softuer për menaxhimin e të dhënave, një bazë të dhënash lehtësisht të kërkueshme e me ndërfaqe të thjeshtë për t'u përdorur. Në vendet ku deklaratat dorëzohen dorazi në letër, regjistrimi i deklaratave dhe informacioni financiar duhet të plotësohen manualisht në bazën e të dhënave dhe deklarata të kontrollohet nëse është e plotë. Në këtë mënyrë, procesi i transferimit të të dhënave ofron mundësinë e parë për zbulimin e parregullsive apo flamujve të kuq. Sidoqoftë, ky është një proces intensiv, që konsumon kohë, e që në një rast ideal do të kërkonte përfshirjen e të paktën dy personave për të shmangur gabimet e mundshme (Hoppe 2014). Disa vende, si Kroacia, punësojnë staf të përkohshëm për transferimin e të dhënave, edhe pse kjo qasje nuk është domosdoshmërisht më e sigurtë (me më pak gabime).

Në disa vende, si Rumania, deklaratat në letër skanohen dhe hidhen në një sistem për menaxhimin e të dhënave dhe mund të aksesohen në format PDF. Baza e të dhënave është e pajisur me filtra kërkimi sipas fushave si emri i zyrtarit publik, pozicioni, agjencia publike dhe data e dorëzimit të deklaratës (OECD 2011). Shumë OJQ argumentojnë se skanimi është i dobishëm vetëm në rastet kur teksti në brendësi të dokumentit është i kërkueshëm e jo i koduar në një imazh. Në të kundërt, dokumentet në formën e imazheve që nuk mund të kërkohet teksti, duhet të shmangen (Hoppe 2014). Baza e të dhënave elektronike mund të jetë në formën e një dokumenti Excel ose në formën e një baze të dhënash e ngritur dhe e përshtatur për nevojat e organit mbikëqyrës. Regjistri mund të organizohet në kolona të vecanta për secilën kategori të dhënash dhe një fushë për komente nga institucioni mbikëqyrës, për të shënuar të dhënat që mungojnë apo parregullsi të tjera. Pavarësisht nga zgjidhja teknike, baza e të dhënave duhet të jetë gjithëpërfshirëse e të mundësojë kërkimin automatik dhe filtrimin e informacionit. Për udhëzime operative mbi mënyrën e hartimit të regjistrave të tillë, mund të konsultoni manualin për përpunimin dhe analizimin e deklaratave të të ardhurave dhe pasurive të zyrtarëve publikë (Hoppe 2014). Proces i transferimit të të dhënave duhet të dizajnohet në mënyrë të tillë që të mundësojë tërheqje të lehtë të informacionit dhe ruajtje të sigurtë të të dhënave. Caktimi i një numri identifikues për secilin zyrtar mund të kontribuojë në gjetjen e informacionit. Shumë sisteme, si ai i Sllovenisë, caktojnë një numër unik për secilin zyrtar, gjë që mundëson gjetjen e shpejtë të të gjitha deklaratave të dorëzuara nga ai zyrtar ndër vite. Kjo bën të mundur që identiteti i një zyrtari të ruhet për qëllime privatësie, gjatë procesit të shqyrtimit dhe verifikimit formal dhe eliminon gabimet që mund të rezultojnë nga emrat e dublikuar (Banka Botërore 2012).

Përdorimi i Teknologjisë për verifikimin e deklaratave të pasurisë

Për të përmbushur funksionin e tij parandalues, procesi i verifikimit duhet të dizajnohet në mënyrë të tillë që të krijojë mundësi për detektimin e pasurimit të paligjshëm. Në parim, ligji përcakton nëse organi mbikëqyrës ka mandatin për verifikimin e përmbajtjes së deklaratave apo jo. Në disa vende, ligjet e privatësisë përjashtojnë mundësinë e verifikimit dhe hetimit mund të shkaktohen vetëm nga pretendimet për shkelje apo plotësim i dyshimtë, jo i saktë i deklaratave, që mund të vihen re gjatë shqyrtimit fillestar të tyre. Disa vende, si Gjeorgjia apo Kroacia, verifikimin e deklaratave e lënë në dorë të publikut ose mediave. Duke qenë se verifikimi i të gjitha deklaratave do të ishte i pamundur dhe jo efektiv në kosto, pjesa më e

madhe e vendeve kanë një sistem verifikimi që, sipas kriterëve të paracaktuara, përzgjedh një kampion të deklaratave për shqyrtim.

Përzgjedhja për verifikim e deklaratave

Ekzistojnë metoda të ndryshme për përzgjedhjen e një kampioni deklaratash për verifikim. Shumë vende përdorin një kombinim të kriterëve të mëposhtëm (Banka Botërore 2012):

- deklaratat e zyrtarëve të lartë: kjo kërkon një bazë të dhënash të përditësuar të zyrtarëve të lartë dhe pozicioneve të tyre
- deklaratat e zyrtarëve nga agjenci të caktuara (tatimet, doganat etj) që kanë risk më të lartë për sjellje korruptive
- deklaratat e zyrtarëve me detyra dhe funksione të vecanta, pavarësisht nga agjencia/institucioni për të cilën/in punojnë (menaxhimi i burimeve shtetërore, prokurimet, dhënia e licencave e lejeve të ndryshme, transaksionet me sektorin privat e publik)
- deklaratat për të cilat janë detektuar flamuj të kuq apo pohime për sjellje të pahijshme o në kundërshtim me ligjin
- verifikim rastësor i një numri të caktuar deklaratash.

Sistemet manuale të dorëzimit të deklaratave janë më të kufizuara në opsionet që ofrojnë për verifikimin e deklaratave dhe procesi i përzgjedhjes së një kampioni është më i vështirë e kërkon më tepër kohë. Nga ana tjetër, sistemet elektronike të tërheqjes së të dhënave i mundësojnë agjencitë të bëjnë verifikime rastësore të deklaratave si dhe t'i japin prioritet kategorive specifike të riskut (Burdescu et al. 2010). Dorëzimi elektronik dhe sistemet e menaxhimit të të dhënave zgjerojnë gamën e opsioneve kosto-efektive për përzgjedhjen e deklaratave për verifikim, sipas pozicionit, agjencive publike specifike, rangut të zyrtarit apo deklarimeve të konsideruara më problematike nëpërmjet flamujve të kuq. Sistemet elektronike bëjnë gjithashtu të mundur përzgjedhjen rastësore dhe verifikimin e deklaratave, në bazë të filtrave specifik. Kjo bën që gjasat për verifikimin e kategorive të ndryshme të zyrtarëve të jenë të barabarta, duke parandaluar përzgjedhjen arbitrare apo të motivuar politikisht (Banka Botërore 2012).

Mënyrat e verifikimit

Procesi i verifikimit mund të përfshijë një numër hapash e qasjesh, si: 1) shqyrtimi formal i deklaratave (duke kontrolluar dorëzimet individuale për mënyrën e plotësimit dhe konsistencën); 2) ndryshimet në pasuri (krahasimi i deklarimeve për të monitoruar ndryshimin ndër vite); 3) kontrolli i deklaratave me burime e baza të dhënash të jashtme (regjistrat e automjeteve, taksave, pronave, bankave, atëherë kur këto informacione janë të disponueshme dhe burime të besueshme); 4) analizimi i deklaratave për mospërputhje potenciale (konflikt interesi) dhe 5) kontrolli i mënyrës së jetesës.

Krahas përzgjedhjes së deklaratave që duhen kontrolluar, teknologjia mund të jetë e dobishme në procesin e verifikimit në nivele të ndryshme:

- Cilësia e deklaratës në dorëzim: kontrollet e thjeshta për numrin e fushave të plotësuara dhe për konsistencën e informacionit të deklaruar, mund të automatizohen
- Identifikimi i flamujve të kuq dhe modeleve të dyshimta: teknologjia bën të mundur kontrollin në mënyrë elektronike të modeleve të përsëritura, për të identifikuar flamujt e kuq dhe parregullsitë (Burdescu et al. 2010). Këtu mund të përfshihen zbulimi i mospërputhjeve, diskrepancave dhe ndryshimeve sinjifikative në krahasimin e ndryshimeve të aseteve nga një deklaratë në tjetrën (Banka Botërore 2012). Një qasje tjetër qëndron në krahasimin e të dhënave dhe elementëve bazë gjatë një deklarate për të identifikuar anashkalimet dhe mospërputhjet.
- Kontrolli i informacionit të deklaruar me baza të dhënash të tjera: agjencia mund gjithashtu në mënyrë elektronike të kontrollojë përputhjen ose jo të informacionit të deklaruar me baza të dhënash shtetërore si taksat, pasuritë e paluajtshme, regjistrat e automjeteve etj. Megjithatë, edhe pse teknologjia mund të lehtësojë në mënyrë të konsiderueshme procesin e detektimit të flamujve të kuq, disa parregullsi mund të zbulohen vetëm nëpërmjet kontrolleve të thelluara nga staf i kualifikuar, vecanërisht kur bëhet fjalë për të dhëna jo numerike (për shembull, ndryshimet e makinave apo vendndodhja e pronave) (Banka Botërore 2012). Për këtë arsye, verifikimi efektiv nuk mund të automatizohet plotësisht dhe nuk mund të zëvendësojë tërësisht ndërhyrjen njerëzore.

Zgjidhje Elektronike për thjeshtimin e aksesit publik në deklaratimet e pasurive

Për vendet që publikojnë deklaratimet e aseteve, teknologjia mund të ndihmojë në thjeshtimin e aksesit publik, duke i mundur përdoruesve të jashtëm të kërkojnë dhe migrojnë të dhëna për qëllimet e tyre. Për shembull, Kroacia bazohet në aksesin publik të deklaratave për qëllime verifikimi. Stafi i Komisionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit transferon informacionin nga deklaratat në letër në website-n e Komisionit, duke bërë të mundur kontrollin publik të tyre (Banka Botërore 2012).

Zgjidhje Teknike

Në përgjithësi, softuerët për menaxhimin e sistemeve të deklaratimit të aseteve mund të zhvillohen për të performuar një numër të caktuar funksionesh, duke përfshirë (Banka Botërore 2012):

- përditësimin e regjistrave të deklarantëve
- dorëzim elektronik të deklaratimeve
- sistem elektronik plotësimi
- bazë të dhënash me mundësi kërkimi
- kontrolli i konsistencës/ identifikimi i flamujve të kuq
- mundësi verifikimi mbi bazë të faktorëve të riskut / përzgjedhje e rastësishme e deklaratimeve për verifikim
- ndërlidhje me agjenci të tjera shtetërore që mundësojnë të dhëna shtesë për deklaratime më të plota

(Ky seksion bazohet kryesisht mbi informacion nga ekspertë të konsultuar për këtë studim.)

Pjesa më e madhe e vendeve që kanë implementuar një sistem elektronik të deklarimit të pasurive kanë zhvilluar e përshtatur zgjidhje teknike të vecanta për të performuar funksionet e sipër përmendura, kryesisht për faktin se specifikimet dhe funksionalitetet e softuer-it duhet të përputhen me legjislacionin vendas dhe detajet e deklaratave nuk janë të unifikuara midis vendeve të ndryshme. Për më tepër, këto zgjidhje teknike mund të dizajnohen për t'i shërbyer qëllimeve të ndryshme. Disa vende përdorin teknologjinë për të rritur numrin e deklarimeve dhe për t'i kujtuar deklarantëve afatet, ndërsa të tjerë kanë parësore publikimin online të deklaratave duke lejuar përdoruesit e jashtëm të përdorin e kontrollojnë të dhënat. Të tjerë e vendosin theksin në procesin e dorëzimit të deklaratave, duke përfshirë karakteristika si plotësimi paraprak me të dhëna nga databaza të tjera shtetërore apo mos lejimi i deklaratave jo të plota apo jo korrekte. Për këto arsye do të ishte shumë sfidues zhvillimi i një sistemi universal të unifikuar që do të plotësonte të gjitha kërkesat e vendeve të ndryshme dhe qasjet e ndryshme të menaxhimit të deklaratave. Një tjetër sfidë për një sistem universal do të ishte nevoja më e madhe për trajnim, krahasuar me trajnimet e vecanta për nevojat ligjore të një vendi të vetëm. Sipas ekspertëve të konsultuar për këtë studim, nga pikëpamja teknologjike, është relativisht e thjeshtë për programuesit të zhvillojnë një softuer që të performojë funksionet e ndryshme që nevojiten për një sistem efektiv të deklarimeve. Megjithatë, është e domosdoshme që institucioni që e kërkon një sistem të tillë të ketë një vizion të qartë se çfarë kërkohet nga softueri dhe duhet t'i japë instruksione të qarta zhvilluesit. Në shumë vende, procedurat për verifikimin financiar të deklaratave në letër janë të dobëta dhe ky proces mund të rezultojë shumë sfidues. Një shembull i një instrumenti teknologjik që mund të ndihmojë një vend apo një agjenci në krijimin e formës individuale të deklarimit është INFORM IAD, një databazë që ofron disa forma deklarimi, ofron akses publik dhe analizë të diskrepancave të të dhënave. Për llogaritjen e diskrepancave nevojiten instrumente të tjerë raportimi dhe analizimi. Për këtë të fundit, agjencia duhet të përcaktojë rregullat e biznesit me të cilat do të duhet të krahasohen e filtrohen deklaratat. Zhvilluar në kuadër të projekteve për deklarimin e të ardhurave dhe aseteve në Bankën Botërore, vendet si Etiopia, Sudani Jugor dhe Tajlanda po zhvillojnë sisteme në bazë të konceptit të instrumentit INFORM IAD.

Shembuj nga vende të ndryshme

Shembujt më poshtë janë përzgjedhur për të ilustruar varietetin e qasjeve teknike dhe sistemeve që vendet e ndryshme kanë implementuar për menaxhimin e skemave të deklarimit të aseteve.

Argjentina

Në Argjentinë nevoja për tranzicion në dorëzim dhe menaxhim elektronik online të deklaratave të pasurive u bë e qartë kur numri i madh i zyrtarëve publikë (afërsisht 36 mijë) që duhet të plotësonin deklaratat e pasurive tejkalonte mundësitë e agjencisë për përmbushjen e mandatit të saj. Si rezultat, sistemi u automatizua duke përfshirë forma për deklarimin online, për plotësimin dhe dorëzimin online të deklaratave, ruajtje elektronike online e të dhënave, si dhe menaxhimin e rekordeve dhe raporteve (Banka Botërore 2013). Programi u zhvillua nga një konsulent vendas dhe zyrtarët publikë mund ta shkarkojnë nga faqja zyrtare e Zyrës Anti-Korrupsion ose ta aksesojnë nëpërmjet një CR-ROM-i. Ky softuer i kërkon përdoruesve të plotësojnë të gjitha fushat e kërkuara përpara se ta dorëzojnë, duke

reduktuar kështu numrin e gabimeve formale apo deklarimeve jo të plota apo të plotësuar në mënyrë jo korrekte. Ai gjithashtu automatizon detektimin e diskrepancave midis të ardhurave të deklaruara nga plotësuesi dhe ndryshimeve të të ardhurave dhe asetëve ndër vite. Sistemi bën të mundur verifikimin sistematik të mbi 5% të zyrtarëve të lartë, si dhe verifikim elektronik dhe auditim të të dhënave në bazë të kategorive të riskut për 95% të tjerët. Njësia e Deklarimit të Aseteve mund të verifikojë rreth 2500 deklarime cdo vit. Sistemi mundëson gjithashtu dhe ruajtjen e të dhënave personale dhe sensitive, si adresat, numrat e llogarive bankare, kopjet e deklarimeve të taksave, duke përdorur proces dorëzimi të dyfishtë (anekse publike dhe private). Softuer-i ndan automatikisht të dhënat në dy pjesë, që i korrespondojnë anekseve publike dhe private. Më pas këto të dhëna dërgohen online për t'u ruajtur në serverat e Njesisë së Deklarimit të Aseteve në Ministrinë e Drejtësisë (aneksi privat është i enkriptuar). Deklarimi privat (aneksi privat) mbahet 'i klasifikuar' e mund të hapet vetëm me urdhër të gjykatës, ndërsa akses në aneksin publik jepet *in situ* në zyrat e Njesisë së Deklarimit të Aseteve. Një listë me emrat dhe postet e zyrtarëve që kanë dorëzuar ose jo deklarimet e tyre duhet të publikohet në internet dhe në faqen zyrtare të publikimeve qeveritare brenda 90 ditëve nga marrja e deklarimeve. Përdorimi i teknologjisë pati një impakt sinjifikativ mbi efektivitetin e skemës së deklarimit të asetëve. Në vitin pas implementimit të sistemit të automatizuar, numri i deklarimeve u rrit nga 67% në 96% dhe kostot e qeverisë për cdo deklarim u zvogëluan nga US\$70 në US\$8. Numri i hetimeve mbi konfliktin e interesit si dhe kërkesat për të deklaruar të dhënat financiare u rritën në mënyrë të konsiderueshme (Banka Botërore 2013). Deklarimet e asetëve në Argjentinë janë rekorde publike dhe gazetat publikojnë shpesh të dhënat e politikanëve të ndryshëm. Në vitin 2012 gazeta *La Nación* në partneritet me *Directorio Legislativo, Poder Ciudadano* – kapitulli i Transparency International në Argjentinë – dhe *Asociacion Civil por Igualdad la Justicia (ACIJ)* zhvilluan një platformë për të shfaqur në mënyrë interaktive e sa më të thjeshtë deklaratat e pasurive të zyrtarëve publikë, gjykatësve dhe ligjvënësve.

Sistemi i Deklarimeve në Meksikë

Në Meksikë, që prej vitit 2002, të gjithë punonjësit e administratës publike duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë deklaratat e tyre të pasurisë nëpërmjet sistemit *Declaranet* (Kossick 2002). Hapi i parë konsiston në krijimin e identitetit elektronik të punonjësit të administratës, që realizohet në pak minuta dhe ka si rezultat gjenerimin e kredencialeve dhe një certifikate digjitale. Zyrtarët publikë mund të përdorin këto kredenciale dhe certifikatën për të dorëzuar e firmosur deklaratën për një periudhë prej pesë vitesh. Me shkarkimin e aplikacionit *Declarant*, punonjësit mund të plotësojnë informacionin e nevojshëm. Të gjitha të dhënat janë të enkriptuara dhe informacioni mbahet konfidencial. Deklaratat e plotësuar saktë firmosen në mënyrë elektronike dhe po në mënyrë elektronike i dërgohen *Secretaria de Contraloria y Desarrollo Administrativo (SECODAM)*. Kjo e fundit njofton marrjen e deklaratave. SECODAM është përgjegjës për verifikimin e deklaratave të asetëve dhe për fillimin e hetimeve kur dyshohet për shtim pasurie jo të ligjshme. Informacioni nga raportet organizohet në formë matricë të të dhënave që mund të analizohen në dimension vertikal ose horizontal, duke bërë të mundur gjurmimin e historikut të asetëve nëpërmjet ekzaminimit të blerjeve, shitjeve, donacioneve dhe trashëgimisë së punonjësit publik. Sistemi gjithashtu lejon ekzaminimin e rekordeve bankare për të siguruar që kursimet dhe shpenzimet janë konsistente dhe në linjë me burimet e njohura të të ardhurave të punonjësit. Më pas SECODAM analizon informacionin e raportuar duke përdorur informacionin e mbledhur nga institucionet e tjera publike (Raile 2004). Implementimi i sistemit fillimisht hasi sfida si kultura

e dobët digjitale në administratën publike, burime modeste, mungesa e internetit e stafit që punonte në zona të izoluar si dhe disa vështirësi teknike (Kossick 2002). Me zhvillimin e sistemit, për të tejkaluar rezistencë e zyrtarëve publikë ndaj teknologjive të reja, qeveria zhvilloi një portal online me instruksione, siguroi sesione trajnimi, krijoi një shërbim ndaj klientit ku mund të telefonohej falas dhe ngriti qendra trajnimi për të ndihmuar punonjësit (Banka Botërore 2012). *Transparencia Mexicana* së fundmi lancoi një platformë që ndihmon qytetarët në identifikimin e kandidatëve elektoralë të tyre dhe fton këta të fundit të bëjnë publik informacionin mbi asetet, interesat dhe deklarin e taksave, i bën të mundur kandidatëve të mësojnë se si mund t'i deklarojnë ato dhe shqyrton informacionin e kandidatëve që kanë plotësuar deklaratat.

Gjeorgjia

Tranzicioni i Gjeorgjisë në një sistem për deklarimin online të aseteve u realizuar në vitin 2010. Programi për dorëzimin online të deklaratave u zhvillua dhe administrua nga Byroja e Shërbimeve Civile (CSB) dhe zëvendësoi plotësisht deklaratat e mëparshme që plotësoheshin manualisht e dorëzoheshin dorazi. Zyrtarët e Lartë duhet të aksesojnë faqen nëpërmjet kredencialeve të vëna në dispozicion nga CSB dhe të plotësojnë deklarinimet e tyre online. Brenda 48 orëve pas dorëzimit të deklarimeve, informacioni publikohet online për vëzhgim publik dhe mund të aksesohet nga kushdo që dëshiron të shkarkojë një kopje. Ndërkohë që ky sistem konsiderohet i qëndrueshëm e transparent, duke bërë publik dhe të aksesueshëm informacionin mbi interesat ekonomik dhe pronat e zyrtarëve publikë, fillimisht informacioni u bë publik nga qeveria në një format që vështirësonet kërkimin dhe përdorimin e të dhënave. *Transparency International Georgia* shkarkoi këto të dhëna, i përpunoi ato dhe i bëri të aksesueshme në një format më të lehtë për t'u kuptuar e përdorur. Me kalimin e kohës qeveria përmirësoi dhe formatin e të dhënave në deklaratat zyrtare. Duke qenë se nuk ekziston një institucion i dedikuar për verifikimin e këtyre deklaratave, verifikimi i mënyrës se si ato plotësohen dhe vërtetësisë së tyre është lënë në dorë të medias dhe publikut. Organizatat e shoqërisë civile verifikojnë deklaratat e politikanëve dhe i krahasojnë ato ndër vite për të detektuar ndryshimet e tyre në interesa dhe të ardhura financiare, e duke i lidhur ato me të dhëna të tjera publike si për shembull regjistri i kompanive, për të kërkuar për konflikt interesi apo pasurim jo të ligjshëm (Transparency International 2013). Shqyrtimet informale të deklaratave të pasurisë nga organizata gjeorgjiane të shoqërisë civile kanë identifikuar mjaft raste ku zyrtarët publikë nuk kanë deklaruar përfshirjen e tyre në kompani të ndryshme të sektorit privat apo të raportojnë të plota asetet e tyre (Open Society Georgia Foundation 2015). Së fundmi parlamenti ka përshtatur disa amendamente që parashikojnë konceptin e verifikimit të deklaratave të aseteve.

Indonezia

Sistemi i deklarimit të aseteve në Indonezi menaxhohet nga Komisioni i Çrrënjësjes së Korrupsionit (KPK), një agjenci e pavarur anti-korrupsioni. Sistemi u prezantuar në vitin 2001 dhe fillimisht ajo fokusohej në përcaktimin e mekanizmave dhe kapaciteteve për menaxhimin e “sistemit të raportimit të pasurisë” dhe rritjen e numrit të deklarimeve midis zyrtarëve që duhet të deklarojnë situatën e tyre financiare. Me rritjen e numrit të deklarimeve nga 56% në 2006 në 85% në 2009-n, KPK-ja tashmë është fokusuar në forcimin e kapaciteteve në verifikim (Banka Botërore 2013 dhe 2012). Dorëzimi i deklaratave bëhet dorazi por proceset administrative dhe operacionale të menaxhimit të të dhënave janë elektronike. Deklarimet dorëzohen në format të printuar e plotësuar (rreth 116,500 në vitin

2009), dhe skanohen për qëllim arkivimi apo tërheqjeje të mëvonshme. Të dhënat procesohen nga një staf prej 80 personash, në bashkëpunim me punonjës të institucioneve që ndihmojnë në validimin e të dhënave. Për pasojë, pjesa më e madhe e stafit në Drejtorinë e Raportimit të Pasurisë janë përgjegjës për procesimin e të dhënave dhe për hedhjen e tyre në një sistem të përshtatur. Stafi teknik shqyrton në mënyrë formale deklaratimet më tepër me qëllimin për të validuar informacionin përsa i përket plotësimit të të gjitha fushave dhe konsistencës së të dhënave, plotësimit të informacionit personal, plotësimit të vlerave dhe totaleve, se sa për të kontrolluar vërtetësinë e tyre. Një kampion i deklaratave prej 1% deri në 5% verifikohet, fillimisht duke u fokusuar në deklaratimet e zyrtarëve në agjenci me rrezik të lartë korrupsioni. Ky kampion përzgjidhet duke kontrolluar manualisht bazat e të dhënave të KPK-së. KPK ka prezantuar analiza dhe raporte të përmirësuara, duke përdorur intrumente inteligjente biznesi dhe menaxhimi të dhënash, të cilat kanë mundësuar opsione të përmirësuara për verifikimin e deklaratave dhe publikimin e statistikave dhe prirjeve. Përmbledhjet e raporteve për publikimin e pasurisë publikohen në gazetën shtetërore dhe online në faqen zyrtare të *Anticorruption Clearing House*. Ky portal mundëson akses publik në statistikave dhe deklaratimeve dhe në raportet e tjera lidhur me performancën e sistemit. Për shembull, Departamenti për Raportimin e Pasurisë analizon informacionin e mbledhur për të nxjerrë raportet e performancës së institucioneve, si numrin e deklaratave të dorëzuara (në total nga zyrat qeveritare, në bazë province, sektori, moshe etj). Raporte të tjera prezantojnë deklaratat e plota dhe vlerat e tyre e mund të analizohen më tej në shumë dimensione të tjera (Banka Botërore 2013).

Sfidat

Përdorimi i teknologjisë kërkon gjithashtu trajnim të përshtatshëm dhe eksperiencë teknike për funksionimin e duhur të sistemeve të menaxhimit të të dhënave. Institucionet anti-korrupsion të sektorit publik në vendet në zhvillim hasin sfida të mëdha në këtë drejtim. Sipas ekspertëve që janë konsultuar në kuadër të këtij studimi, shumë prej agjencive kanë vështirësi të kuptojnë se si teknologjia dhe menaxhimi i të dhënave mund të përdoren efektivisht për të arritur qëllimet e tyre. Shumë shpesh institucionet anti-korrupsion nuk kanë njohuri mbi aplikacionet softuer që duhet të prokurojnë.

Kjo situatë vështirësohet nga mungesa e një strategjie koherente e praktike kombëtare mbi menaxhimin e informacionit, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave, ruajtjen dhe tërheqjen e tyre si dhe sigurinë e të dhënave.

Për këto arsye, një strategji ICT e qartë është një kërkesë kritike paraprake, përpara investimit të shumave të konsiderueshme të parave në blerjen e harduer-ëve dhe softuer-ëve të kushtueshëm.

Për më tepër, agjencitë qeveritare kanë tendencën të operojnë si të pavarura dhe të zhvillojnë platformat dhe sistemet e tyre, duke kontraktuar operatorët lokalë apo programuesit e preferuar, pa marrë në konsideratë çështje kyce si ndërveprimi i sistemeve të menaxhimit të të dhënave midis agjencive qeveritare dhe bashkëpunimi për ekspozimin dhe ndjekjen e suksesshme të rasteve korruptive. Kjo mund të sjellë sfida madhore për menaxhimin e deklaratave të aseteve, pasi mosfunksionimi i një agjencie do të ketë impakt të drejtpërdrejtë mbi një tjetër dhe do të rrezikojë shkëmbimin e informacionit midis agjencive si Njësia e Inteligjencës Financiare apo institucioneve të prokurorisë.

Për shembull, dobësia e zgjidhjeve teknologjike të përdorura për menaxhimin e burimeve njerëzore do të ndikojë në kapacitetin e institucionit inspektues në identifikimin efektiv të zyrtarëve publik që kërkohet të dorëzojnë deklaratimet e tyre. Në të njëjtën mënyrë, Njësia e

Inteligjencës Financiare mund të ketë sistemin e saj dhe mund të përdorë bazë të dhënash jo të përshtatshme për të mbledhur nga bankat raportet e aktiviteteve të dyshimta, të cilat përbëjnë informacion mjaft të vlefshëm për kontrollin dhe zbulimin e korrupsionit dhe pastrimit të parave.

Në shumë raste, institucionet e prokurorisë kanë sistemet e tyre për menaxhimin e informacionit, që do të duhet të aksesojnë të dhënat e deklarimeve në kohë reale, në mënyrë që të tërhiqet informacioni i nevojshëm për verifikim të mëtejshëm. Nëse sistemet e të dhënave të këtyre agjencive nuk janë të ndërlidhura dhe operojnë më vete, automatizimi i menaxhimit të të dhënave në sistemet e deklarimit të aseteve dhe të ardhurave mund të arrijë rezultat e pritura të detektimit të korrupsionit dhe pasurimit të paligjshëm.

Një ndërlidhje e tillë midis agjencive është edhe më e rëndësishme në praktikë, pasi është relativisht e rrallë që analiza vetëm e deklarimeve të cojë në zbulimin e aktivitetit korruptiv (Messick 2014).

Kostot

Në marrjen e vendimit për përdorimin apo jo të teknologjisë për menaxhimin e deklaratave të aseteve, është e rëndësishme të merren në konsideratë kostot që lidhen me zhvillimin dhe implementimin e teknologjisë, si dhe kostot afatgjata për mirëmbajtjen, përdorimin dhe përditësimin e programeve dhe pajisjeve (Hoppe 2014). Përdorimi i teknologjisë për menaxhimin e deklaratave të të ardhurave dhe aseteve kërkon jo vetëm investime në zhvillimin e një programi të posacëm dhe blerjen e pajisjeve të nevojshme harduer, por edhe kosto për mirëmbajtjen e kompjuterave, serverave dhe kapacitetit ruajtës të sistemit (Banka Botërore 2012). Për shembull, në Argjentinë, pajisjet harduer nuk janë rinovuar që prej vitit 2000 kur sistemi elektronik filloi të përdorej, duke shkaktuar kështu shpejtësi më të ulët procesimi kundrejt rritjes së të dhënave në bazën e të dhënave, duke arritur në 33 mijë zyrtarë që duhet të plotësonin dokumentat elektronikisht për deklaratimet e tyre (Banka Botërore 2012).

Referenca

- OECD (2011), *Asset Declarations for Public Officials: A Tool to Prevent Corruption*, OECD Publishing. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264095281-en> <http://www.oecd.org/corruption/anti-bribery/47489446.pdf>
- World Bank Group/Alexandra Habershon, Stephanie Trapnell: “Public Office, Private Interests: Accountability Through Income and Asset Disclosure” (2012) <https://star.worldbank.org/sites/star/files/Public%20Office%20Private%20Interests.pdf>
- RAI, Rules and Experiences on Integrity Issues (2012)
- ReSPA Regional School of Public Administration, Comparative Study, Income and Asset Declarations in Practice
- U4 The use of technology for managing income and asset declarations <https://www.u4.no/publications/the-use-of-technology-for-managing-income-and-asset-declarations.pdf>
- Baron M. 2013. OpenGov Voices: Opening Asset Declarations in Argentina – More than a Decade of Struggle. <https://sunlightfoundation.com/blog/2013/10/28/opengovvoices-opening-asset-declarations-in-argentina-more-than-a-decade-of-struggle/>
- Burdescu R., Reid J., Trapnell E., Barnes W. 2010. Income and Asset Disclosure Systems: Establishing Good Governance through Accountability. <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/10175>
- Hoppe T. 2014. Practitioner Manual on Processing and Analysing Income and Asset Declarations of Public Officials, Eastern Partnership-Council of Europe Facility Project on “Good Governance and Fight against Corruption”
- Kossick R. 2002. Mexico Declaranet System: Enhancing Public Sector Efficiency, Transparency and Accountability through the Automation and Disintermediation of the Patrimonial Declaration Process. <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/UNP AN/UNPAN007621.pdf>
- Messick. R. 2014. Income and Asset Disclosure Statements: No Anticorruption Magic Bullet. Global Anti-corruption Blog. <http://globalanticorruptionblog.com/2014/04/23/income-andasset-disclosure-statements-no-anticorruption-magic-bullet/>
- Open Society Georgia Foundation. 2015. Verification of Asset Declarations: Why Georgia Needs it and What International Practice Tells Us, Policy brief. http://www.osgf.ge/files/2015/Publication/EUGeorgia%20Association%20Angarishi_A4_1.pdf
- Raile E. 2004. Managing Conflicts of Interest in the Americas: A Comparative Review, OECD. http://www.right2info.org/resources/publications/assetdeclarations/oecd_managing-conflict-of-interests-in-the

Aneks 1

Risk	Shpjegimi i riskut	Niveli i riskut	Ndihma
Ekzistenca e trajnimeve të përshtatshme dhe eksperiencës teknike	Vështirësi në kuptimin e mënyrave se si teknologjia dhe menaxhimi i të dhënave mund të përdoren për të arritur në mënyrë efektive qëllimet	I Lartë	Trajnime dhe asistencë teknike
Menaxhimi dhe aksesimi në të dhëna	Mungesa e një strategjie kombëtare koherente për menaxhimin e informacionit, përfshirë mbledhjen e të dhënave, ruajtjen, tërheqjen si dhe sigurinë e tyre.	I Lartë	Konsensus kombëtar dhe zhvillimi i një strategjie kombëtare
Baza të dhënash të fragmentuara Realizimi i hetimeve proaktive kërkon komunikim midis bazave të ndryshme të të dhënave dhe të drejta për akses në nivele të ndryshme	Agjencitë qeveritare kanë tendencën të operojnë të pavarura dhe të zhvillojnë platformat dhe sistemet e tyre, duke përdorur kontraktorë lokalë e programues sipas preferencave, duke mos marrë parasysh çështje si komunikimi midis sistemeve që zhvillon secila, me qëllim bashkëpunimin për ekspozimin dhe ndjekjen e çështjeve korruptive.	I Lartë	Ibid
Kontrolli i dorëzimit të deklaratave	Mungesë informacioni mbi zyrtarët publikë. Ndryshimet e shpeshta dhe përpjekje jo	I Lartë	Krijimi i një regjistri që të përditësohet rregullisht.

	sistematike për të krijuar një regjistër ndër-qeveritar		
Kostot	Kostot lidhur me zhvillimin dhe implementimin e teknologjisë si dhe kostot për mirëmbajtjen e përditësimin afatgjatë të sistemit dhe pajisjeve	I Lartë	Është e rëndësishme të merren parasysh kostot për zhvillimin e implementimin e teknologjisë, si dhe kostot për mirëmbajtjen e përditësimin afatgjatë të sistemit dhe pajisjeve.
Verifikimi	Monitorimi i duhur i ligjshmërisë së aseteve dhe të ardhurave është teknikisht më sfidues se sa kontrolli i konfliktit të interesit.	I Lartë	Debate mbi politikat e duhura lidhur me modifikimin e sistemeve të deklarimit. Ndërkohë që aktorët ndërkombëtarë mund të luajnë rol të rëndësishëm si katalizatorë të ndryshimit, ata duhet të angazhohen në debate me partnerë lokalë përfshirë politikanë, agjenci qeverite, OJF dhe media.

Aneks II

Raport krahasues midis kuadrit legjislativ në Shqipëri, rregulluar me Ligjin Nr. 42/2017 „Mbi Deklarimin dhe Auditimin e Aseteve, Obligimeve Financiare të Personave të Zgjedhur dhe disa Zyrtarëve Publikë“ dhe një praktike të mirë.

Tabelë me ngjashmëritë në legjislacion:

	Shqipëria	Rumania	Argjentina	Gjeorgjia	Maqedonia
Ligj i vecantë	x	x	Jo	Ligji për Konfliktin e Interesit	Jo
Deklarim dhe auditim	x	x	Jo	x	Draft-Ligj i ri
Asetet dhe konflikti i interesit	x	x	Asetet	x	x
Verifikimi	x	x		x	
Konfiskimi		x			Taksimi
Publikimi	x	x	x	x	x
Dorazi dhe elektronikisht		x	x	x	Ligj i ri